



RAPORT
HULUMTIMI

**NEVOJAT
DHE PROBLEMET
E NJERËZVE
LGBTIQ NË
REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË
VERIUT**

Raport hulumtimi: Nevojat dhe problemet e njerëzve LGBTIQ në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Botues:
Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut - Shkup
Qendra për mbështetje LGBTI

Redaktor:
Uranija Pirovska, Drejtoreshë Ekzekutive

Për botuesin:
Neda Zdraveva, Presidente

Autore:
Biljana Ginova

Recensa:
Biljana Kotevska

Përkthimi:
Shenasi Jaji

Dizajni, përgatitja dhe shtypi:
KOMA

Tirazhi:
500

Tirazh falas/jokomercial

Shkup, maj 2021



“Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të personave LGBTI në Maqedoni”, i mbështetur nga Misioni i Përhershëm i Mbretërisë së Holandës në OSBE. Opinionet, gjetjet, përfundimet ose rekomandimet e parashtruara këtu janë përgjegjësi vetëm e implementuesve dhe jo gjithmonë shprehin pikëpamjet dhe opinionet e donatorit”.

Falënderim

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Qendra për mbështetje LGBTI shprehin mirënjohjen e tyre të përzemërt për të gjithë ata që kanë punuar me përkushtim dhe përpikmëri në zbatimin dhe botimin e këtij hulumtimi:

→ Për të gjithë njerëzit e guximshëm që ndanë përvojat e tyre në interes të këtij hulumtimi. Pa to, ky raport nuk do të ishte i mundur. Të gjitha rekomandimet që ata ndanë me ne janë prioritetet tona, për të cilat premtojmë se do të angazhohemi dhe do t'i avokojmë çdo ditë.

→ Për intervistuesit: Aleksandra Stojanovska, Bllagoja Jovanovski, Elena Gagovska, Elena Petrovska, Ermin Omeroviç, Jovan Josifovski, Kristijan Matoski, Maja Balshiqevska, Predrag Jovanovski, Semran Sulejman për testimin dhe sigurimin e komenteve në mënyrë që të përmirësojnë pyetëtorin, veçanërisht për organizimin me kujdes të bisedave me njerëzit e komunitetit LGBTIQ për dokumentimin e përvojave të tyre.

→ Për Biljana Kotevska për rishikimin, këshillat dhe të gjitha udhëzimet për përmirësimin e raportit të hulumtimit;

→ Për Jovana Jovanovska dhe Sanja Stefanoviç për të gjithë mbështetjen logjistike në zbatimin e hulumtimit, si dhe për komentet e tyre në drejtim të përmirësimit të pyetëtorit dhe hulumtimit në përgjithësi;



СОДРЖИНА

1. PËRMBLEDHJE E REZYMESË	9
2. Hyrje	10
2.1. Konteksti shoqëror dhe juridik.....	11
2.2. Qëllimi i hulumtimi	13
3. METODOLOGJIA	14
3.1. Të dhënat parësore	14
3.2. Të dhënat dytësore	15
3.2.1. Pyetësi.....	15
3.2.2. Mbledhja e të dhënave	15
3.2.3. Mostra hulumtuese dhe të dhënat demografike	17
4. GJETJET E HULUMTIMIT	19
4.1. Qasja në shërbimet e mbrojtjes sociale	19
4.2. Qasja në shërbimet e mbrojtjes shëndetësore	28
4.2.1. Qasja në shërbimet e gjinekologut	30
4.2.2. Qasja në shërbimet e mbrojtjes shëndetësore parësore dhe dytësore të personave trans	33
4.3. Qasja në arsim	35
4.4. Qasja në punësim	38
4.5. Dhuna dhe dhuna në familje.....	40
4.6. Veprimi i policisë	46
4.6.1. Veprimi i policisë ndaj personave lgbtiqë.....	47
4.6.2. Trajtimi policor i viktimave lgbtiqë	50
4.6.3. Zbatimi i forcës së pabazuar dhe të tepruar ndaj personave LGBTIQ nga ana e punonjësve të policisë.....	52
4.6.4. Raportimi i rasteve të zbatimit të forcës së pabazuar dhe të tepruar nga ana e punonjësve të policisë.....	52
4.6.5. Besimi i personave lgbtiqë se policia do t'i mbrojë kur të kenë nevojë për ta	54
4.7. Qasja në shërbimet e tjera	55
4.8. Informacion nga ana e institucioneve.....	57

5. PASQYRË KRAHASUESE E GJETJEVE TË HULUMTIMIT TË KRYER NË VITIN 2015 DHE ATIJ TË KRYER NË VITIN 2020	59
5.1. Qasja në shërbimet e mbrojtjes sociale	59
5.2. Qasja në shërbimet juridike	60
5.3. Pyetje nga fusha e veprimit të policisë	61
5.3.1. Veprimi i policisë ndaj personave LGBTIQ	62
5.3.2. Trajtimi policor i viktimave LGBTIQ	63
5.3.3. Zbatimi i forcës së pabazuar dhe të tepruar ndaj personave LGBTIQ nga ana e punonjësve të policisë	64
5.3.4. Raportimi i rasteve të zbatimit të forcës së pabazuar dhe të tepruar nga ana e punonjësve të policisë	64
5.3.5. Besimi i personave lgbtiq se policia do t'i mbrojë kur të kenë nevojë për ta	65
6. PËRFUNDIM DHE REKOMANDIME	65
6.1. Përfundim	65
6.2. Rekomandime	67
6.2.1. Përmirësimi dhe zbatimi i kornizës ligjore	67
6.2.2. Ngritja e kapaciteteve të sistemeve institucionale	68
6.2.3. Lehtësimi i qasjes në informacion dhe rritja e vetëdijes publike	68
7. SHTOJCA	70
Shtojca 1 – pyetësor për përcaktimin e qasjes në shërbime dhe mbrojtja e personave LGBTIQ në republikën e maqedonisë së veriut	70
Shtojca 2 – tabela 2: numri i të anketuarve që iu përgjigjën pyetësorit të dhënë me pyetje	97
Shtojca 3 – tabela 3: pasqyrë krahasuese e gjetjeve nga fusha “qasja në shërbimet e mbrojtjes sociale”	98
Shtojca 4 – tabela 4: pasqyrë krahasuese e gjetjeve nga fusha “qasja në shërbimet juridike”	101
Shtojca 5 – tabela 5: pasqyrë krahasuese e gjetjeve nga fusha “veprimi i policisë”	103



FJALOR TERMASH

Fjalori i termave është përgatitur në mënyrë që të kuptohet terminologjia e përdorur në raport dhe të përshkruhen konceptet në lidhje me orientimin seksual, identitetin gjinor, shprehjen gjinore dhe karakteristikat gjinore.

AKRONIME

LGBTIQ	Lezbiket, meshkujt gay, biseksualët, transgjitorët, interseksi dhe queer
OSIGj	Orientimi seksual dhe identiteti gjinor
OSIShGjKkG	Orientimi seksual, identiteti dhe të shprehurit gjinor dhe karakteristikat gjinore
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
OJQ	Organizatë joqeveritare
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
VMRO-DPMNE	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas

PËRKUFIZIME

Lista e përkufizimeve i referohet termave të përmendur në këtë tekst. Janë përfshirë përkufizime që përdoren shpesh nga organizatat LGBTIQ. Ky hulumtim merr parasysh se për shumë njerëz, seksi, gjinia dhe seksualiteti nuk janë kategori ekstreme, por një spektër i qenies.

Seksi	Klasifikimi i një personi si femër, mashkull ose interseks. Foshnjave u caktohet zakonisht një seks në lindje sipas pamjes së anatomisë së tyre të jashtme. Gjinia e secilit person është një kombinim i karakteristikave fizike, duke përfshirë kromozomet (zakonisht kromozomi XY = mashkull dhe kromozomi XX-femër), organet riprodhuese dhe karakteristikat sekondare të seksit
Karakteristikat e seksit	Karakteristikat fizike të secilit person në lidhje me seksin, të tilla si organet gjenitale, anatomia riprodhuese, kromozomet, hormonet dhe karakteristikat dytësore fizike që shfaqen në fazën e pubertetit
Interseks (Ndërseks)	Një term që përdoret për njerëzit që kanë një ose më shumë variacione të karakteristikave të seksit fizik të ndryshëm nga konceptet tradicionale të trupit mashkull dhe femër. Disa tipare interseksuale mund të identifikohen që në lindje, por disa mund të mos vërehen deri në pubertet ose më vonë gjatë jetës. Interseksi nuk është sinonim i një personi transgjitor
Interseksfobia	Interseksfobia (ose interfobia) paraqet një grumbull idesh dhe fenomenesh që përfshijnë një sërë qëndrimesh, ndjenjash ose veprimesh negative ndaj individëve që besohet se posedojnë karakteristika biologjike seksuale që nuk janë tipike mashkull apo femër (pavarësisht nëse janë të lindur interseksuale ose manifestojnë identitet dhe shprehja gjinore jo binare që zakonisht lidhen me karakteristikat e lindura interseksuale).
Gjinia	Gjinia i referohet attributeve, pritjeve dhe normave sociale, bihevioristike (të sjelljes) dhe kulturore që lidhen me burrërinë dhe femërinë. Në këtë hulumtim, gjinia kuptohet si një koncept jo binar.
Identiteti gjinor	Përvoja personale dhe të kuptuarit e gjinisë së dikujt që mund të lidhet me ose të ndryshojë nga gjinia e përcaktuar gjatë lindjes (të qenit burrë, grua, diçka në mes, asgjë ose diçka jashtë të kuptuarit binar të gjinisë). Identiteti gjinor paraqet një ndjenjë të brendshme që nuk është gjithmonë e dukshme për të tjerët.
Shprehja gjinore	Mënyra se si një person shpreh gjininë e tij ose të saj në marrëdhëniet/ndërveprimet me të tjerët, duke përfshirë veshjen, stilin e flokëve, zërin, sjelljen, përdorimin e përemrave.

Cisgjinia	Cis ose cisgjinator/e i referohet një personi, identiteti gjinor i të cilit është në përputhje me seksin e specifikuar në lindje.
Transgjinia	Transgjinatorët i referohen një personi, gjinia e të cilit në lindje nuk përputhet me identitetin e tij/saj gjinor/e.
Transfobia	Një grup idesh dhe fenomenesh që përfshijnë një sërë qëndrimesh, ndjenjash ose veprimesh negative ndaj njerëzve transgjinatorë ose transgjinisë në përgjithësi. Transfobia mund të përfshijë frikë, neveri, urrejtje, dhunë, zemërim ose pakënaqësi ndaj njerëzve që nuk i përmbushin pritjet gjinore të shoqërisë. Është një formë paragjykimi dhe diskriminimi, e ngjashme me racizmin dhe seksizmin.
Orientimi seksual	Kapaciteti i përhershëm i secilit person për ndjenja të thella romantike, emocionale dhe/ose fizike ose atraktivitet ndaj një personi (ave) të një seksi ose gjinie të caktuar. Kjo përfshin heteroseksualitetin, homoseksualitetin dhe biseksualitetin dhe një spektër të gjerë të shprehjeve të tjera të orientimit seksual.
Lezbike	Një grua që ka një tërheqje/atraktivitet romantike, emocionale dhe/ose fizike ndaj grave të tjera. Ky hulumtim merr parasysh se një lezbike mund të jetë person aseksual, transgjinor, homoseksual, jo binar dhe të ngjashme.
Burrë homoseksual	Një burrë që ka një tërheqje/atraktivitet romantike, emocionale dhe/ose fizike ndaj burrave të tjerë. Termi "homoseksual" përdoret ndonjëherë edhe nga gratë gjithashtu. Ky hulumtim merr parasysh që një homoseksual mund të jetë person aseksual, transgjinor, jo binar dhe të ngjashme.
Persona biseksualë	Personat që kanë një tërheqje romantike, emocionale dhe/ose fizike ndaj njerëzve të shumë gjinive.
Queer	Një term i zakonshëm për pakicat seksuale dhe gjinore që nuk janë heteroseksualë ose të cisgjinatorë. Ky hulumtim merr parasysh dimensionin historik të përdorimit të këtij termi, respektivisht se ky term është përdorur si fyerje ndaj homoseksualëve dhe lezbikeve, por më vonë u përvetësua nga aktivistët si një term vetë-identifikues.
Pakicat seksuale dhe gjinore	Personat, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore e të cilëve ndryshojnë nga ato të grupit shumicë në shoqëri.
Persona heteroseksualë	Personat që kanë një tërheqje romantike, emocionale dhe/ose fizike ndaj personave të seksit dhe/ose identitetit të kundërt gjinor sesa të tyre.
Homofobia	Një grup idesh dhe fenomenesh që përfshijnë një sërë qëndrimesh, ndjenjash ose veprimesh negative ndaj homoseksualitetit dhe personave që perceptohen si homoseksualë.
Lezbofobia	Një grup idesh dhe fenomenesh që përfshijnë një sërë qëndrimesh, ndjenjash ose veprimesh negative ndaj të qenit lezbike dhe personave që perceptohen si lezbike.
Bifobia	Një grup idesh dhe fenomenesh që përfshijnë një sërë qëndrimesh, ndjenjash ose veprimesh negative ndaj biseksualitetit dhe personave që perceptohen si biseksualë.
Të drejtat e njeriut	Liritë dhe të drejtat që u takojnë të gjithëve sepse janë qenie njerëzore. Të drejtat e njeriut janë një respekt për dinjitetin njerëzor dhe një siguri që të kenë mjete për të jetuar, për t'u zhvilluar dhe për të marrë pjesë në shoqëri. Këto të drejta janë universale dhe nuk duhen pamundësuar askujt.
Diskriminimi	Trajtimi i pabarabartë nga çdo person juridik publik ose privat ose person fizik ndaj një personi ose grupi të caktuar personash për shkak të karakteristikave të tyre personale si: raca, ngjyra e lëkurës, përkatësia etnike, seksi, gjinia, orientimi seksual, identiteti dhe shprehja gjinore, karakteristikat seksuale, feja, aftësia e kufizuar, moshja, statusi familjar ose martesor, gjendja shëndetësore ose ndonjë bazë tjetër.
Dhuna në familje	Dhuna ndaj një bashkëshorti/es, midis prindërve dhe/ose fëmijëve dhe/ose personave të tjerë që jetojnë në një bashkësi martesore ose jashtëmartesore ose familje të përbashkët, si dhe ndaj një ish ose bashkëshorti/e aktual/e, partneri jashtëmartesor ose midis personave që kanë një fëmijë të përbashkët ose janë në një marrëdhënie të afërta personale, pavarësisht nëse autori ndan ose ka ndarë të njëjtën banesë me viktimën apo jo.

1

PËRMBLEDHJE E REZYMESË

Ky hulumtim është kryer për të kuptuar më mirë nevojat dhe problemet me të cilat ballafaqohen lezbiket, meshkujt gay, biseksualët dhe biseksukët, transgjjinorët, interseksualët dhe queer-ët (LGBTIQ) në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). Hulumtimi bazohet në një hulumtim të kryer nga Qendra për Mbështetje LGBTI në vitin 2015. Për më tepër, ky hulumtim mblodhi informacione specifike mbi përvojat e personave LGBTIQ në lidhje me diskriminimin sa i përket qasjes në arsim dhe shëndetësi.

Përvojat kolektive të njerëzve LGBTIQ tregojnë një nivel të lartë ekspozimi ndaj diskriminimit, ngacmimit dhe dhunës për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore. Megjithatë, shumica e tyre nuk e raportojnë atë tek institucionet përgjegjëse, kryesisht për shkak të mosbesimit se rasti do të zgjidhet dhe frikës se mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për ta. Ata pak që janë inkurajuar të raportojnë, zakonisht janë përballur me diskriminim shtesë ose trajtim të papërshtatshëm për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore, ose veprimit jo në kohë dhe joefikas, gjë që kontribuon edhe më shumë në rritjen e nivelit tashmë të lartë të mosbesimit ndaj institucioneve.

Pothuajse të gjithë personat LGBTIQ që morën pjesë në hulumtim besojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm se si të njohin diskriminimin dhe dhunën bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe/ose shprehjen gjinore dhe ku të denoncojnë për të siguruar mbrojtje ligjore. Përveç kësaj, shumë prej tyre besojnë se nevojitet trajnim i vazhdueshëm i zyrtarëve në institucione, fushata publike, si dhe masa afirmative për punësimin e personave LGBTIQ në institucionet që ofrojnë shërbime sociale në një komunitet ose institucion.

Hulumtimi u krye midis 217 të anketuarve nga i gjithë territori i RMV-së, dhe gjetjet tregojnë se 56.67% e të anketuarve shprehën pakënaqësi me qëndrimin e shërbimit profesional në përdorimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale (shërbimet sociale në një institucion dhe në një bashkësi lokale). Arsyet më të zakonshme të pakënaqësisë janë diskriminimi dhe qëndrimi joadekuat i punonjësve për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të të anketuarve (42.86%) dhe veprimi i vonuar dhe/ose joefikas (38.78%). Është shqetësuese që asnjë nga të anketuarit që i mbijetuan diskriminimit me rastin e përdorimit të shërbimeve sociale në bashkësinë lokale, në një institucion ose nga shërbimi profesional nuk e ka raportuar rastin në ndonjë institucion apo organizatë përkatëse.

Pothuajse gjysma e të anketuarve (49.25%) u diskriminuan në kuadër të procesit arsimor nga shokët e klasës, stafit mësimor ose

administratës, dhe 81.19% e tyre nuk e kishin raportuar rastin në ndonjë institucion kompetent. 20.71% e të anketuarve u diskriminuan në qasjen në punësim në vendin e punës, dhe 16.76% në procesin e punësimit (gjatë intervistave, testimave për pozicionin e punës dhe të ngjashme) për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore. Shumica e tyre (87.89%) nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit në asnjë institucion apo organizatë kompetente.

Gjysma e të gjithë të anketuarve (51.17%) i mbijetuan një forme dhune për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore. Katër nga pesë të anketuarit (82.14%) nuk e kanë raportuar rastin në ndonjë institucion kompetent ose OJQ. Nga ata, 17.86% që raportuan dhunën, 73.33% ishin të pakënaqur me veprimin e institucioneve, më shumë se gjysma (53.85%) për shkak të diskriminimit dhe veprimet joadekuat nga zyrtarët për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore, dhe 46.15% për shkak të veprimet të vonuar dhe joefikas.

Gjetjet tregojnë një shkallë të lartë diskriminimi dhe qëndrimi joadekuat për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore të të anketuarve, si dhe qëndrimin të përgjithshëm joprofesional dhe abuzimit të autoritetit nga ana e punonjësve të policisë. Kështu, një e treta e të anketuarve që kishin kontakte me oficerët e policisë jashtë stacionit policor ishin të diskriminuar (31.31%). Perceptimi për qëndrimin joprofesional të punonjësve të policisë mbështetet edhe nga të dhënat që lidhen me zbatimin e kompetencave të veçanta të policisë. Gjetjet tregojnë se vetëm 17.24% e punonjësve të policisë ishin vetë-identifikuar me iniciativën e tyre dhe 4.83% prej tyre e kishin bërë këtë me kërkesë të të anketuarve. Kjo kontribuon në rënien e besimit të njerëzve LGBTIQ ndaj tyre. Për më tepër, katër nga pesë të anketuar (88.95%) u përgjigjën se nuk i besojnë policisë se do t'i mbrojnë ata ose të drejtat e tyre kur ata kanë nevojë.

Gjetjet e hulumtimit treguan një rënie të vogël të perceptimit të diskriminimit dhe dhunës në krahasim me vitin 2015, por një rritje të konsiderueshme të mos raportimit të atyre rasteve në institucionet përgjegjëse. Mund të supozohet se mbështetja publike nga udhëheqja politike në RMV-së, promovimi i legjislacionit që synon mbrojtjen e të drejtave të njerëzve LGBTIQ, por edhe punën e organizatave LGBTIQ, fushatat publike për të promovuar pozicionin e njerëzve LGBTIQ dhe mbajtjen e suksesshme të Paradës së parë të krenarisë në Shkup, kontribuan në një rënie të perceptimit për diskriminimin dhe dhunën. Megjithatë, kjo nuk është e mjaftueshme, sepse të dhënat tregojnë një nivel më të lartë mosbesimi në institucione në krahasim me vitin 2015.

Gjetjet përmbledhëse të hulumtimit konfirmojnë se personat LGBTIQ kanë qasje të kufizuar në të drejtat dhe shërbimet për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore në RMV. Prandaj, është e nevojshme të ndërmerren hapat dhe masat e duhura nga të gjithë aktorët, por mbi të gjitha nga institucionet shtetërore, në mënyrë që të mbrohen të drejtat e personave LGBTIQ në vendin tonë. Rekomandimet e përfshira në këtë raport bazohen në përfundimet e këtij hulumtimi, rekomandimet e të anketuarve dhe rekomandimet e organizatave LGBTIQ, të redaktuara në tri fusha:

- Promovimi dhe zbatimi i kornizës ligjore;
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve; dhe
- Lehtësimi i aksesit në informacion dhe ngritja e vetëdijes publike.

Zbatimi në kohë dhe i plotë i këtyre rekomandimeve është vendimtar që njerëzit LGBTI të jenë në gjendje të jetojnë jetën e tyre pa dhunë dhe diskriminim dhe të realizojnë potencialin e tyre të plotë.

2 HYRJE

2.1. Konteksti shoqëror dhe juridik

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV), qasja në shërbime dhe ushtrimi i të drejtave LGBTIQ janë ende të kufizuara. Megjithë ndryshimet pozitive ligjore dhe mbështetjen publike të deklaruar nga udhëheqja më e lartë shtetërore, personat LGBTIQ ende përballen me pengesa në ushtrimin e të drejtave të tyre, janë të ekspozuar ndaj stigmës, diskriminimit dhe aksesit të padrejtë në mundësi.

Në vitin 2015, konteksti politiko-shoqëror ishte shumë i ndryshëm në krahasim me vitin 2020. Gjuha homofobike dhe transfobike e urrejtjes ende inkurajohej dhe praktikohej nga udhëheqja e atëhershme shtetërore dhe udhëheqësit fetarë. Asnjë ligj nuk përfshin identitetin gjinor si një kategori të mbrojtur, dhe legjislacioni kundër diskriminimit si dhe kodi penal në fushën e krimeve të urrejtjes nuk përfshinin orientimin seksual dhe identitetin gjinor si kategori të mbrojtura. Periudha midis vitit 2012 dhe 2015 shënon një rritje të konsiderueshme të dhunës kundër pakicave gjinore dhe seksuale. Gjatë asaj kohe, Qendra për mbështetje LGBTI u sulmua gjashtë herë. Dy nga ato sulme ndodhën gjatë ngjarjeve ku morën pjesë më shumë se 40 persona. Përveç faktit se ai nuk u akuzua për asnjë prej krimeve të urrejtjes bazuar në dëshmi të forta nga regjistrimet me video, nuk pati asnjë dënim publik të dhunës nga lidershipi politik i atëhershëm. LGBTIQ dhe aktivistët e të drejtave të njeriut e interpretuan këtë si një nxitje për të vazhduar dhunën homofobike dhe transfobike, siç dëshmohet nga rritja e veprave të dokumentuara penale dhe gjuha e urrejtjes kundër grupeve dhe individëve të perceptuar si LGBTIQ.

Në vitin 2017, pas njëmbëdhjetë vitesh qeverisje, VMRO-DPMNE-ja demokristiane u zëvendësua nga një koalicion socialdemokrat i udhëhequr nga LSDM-ja. Fokusi kryesor i qeverisë së sapoformuar të promovuar në publik ishte në reformat e shpejta për të rivendosur sundimin e ligjit dhe për të ndërtuar një "shoqëri për të gjithë". Në këtë kontekst, për herë të parë në historinë e vendit, pasuan disa deklarata publike për mbështetjen e personave LGBTIQ nga zyrtarë të lartë shtetërorë: Ministri i Kulturës hapi Fundjavën e Krenarisë në Shkup 2017, dhe në vitin 2018, Ministria ishte ndër donatorët për festivalin dhe me një kontribut të vogël por shumë domethënës, për herë të parë, një ngjarje LGBTIQ ishte financuar nga fondet shtetërore. Në dhjetor të vitit 2017, ministri i punëve të brendshme hapi konferencën "Qasja në Drejtësi për personat LGBTI" me fjalët se Kodi Penal duhet të ndryshohet dhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor (OSIGj) të njihen si baza për veprat penale nga urrejtja. Një nga deklaratat më të rëndësishme publike u bë nga Kryeministri

në përvjetorin e pestë të Qendrës për mbështetje LGBTI në vitin 2017, në shenjë solidariteti me ata që i mbijetuan sulmeve të urrejtjes dhe dënimit të dhunës dhe diskriminimit kundër njerëzve LGBTIQ.¹

Në dy vitet e ardhshme, Kuvendi i RMV-së mori masa konkrete për të promovuar të drejtat e njerëzve LGBTIQ. Në dhjetor të vitit 2017, u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).² Konventa e Stambollit si një dokument gjithëpërfshirës, i detajuar dhe ligjërishit detyrues është një hap i rëndësishëm përpara në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTIQ, pasi dispozita ekzistuese e mosdiskriminimit përfshin orientimin seksual dhe identitetin gjinor. Me ratifikimin e kësaj konvente, për herë të parë u përfshi identiteti gjinor në legjislacionin maqedonas.

Në periudhën midis hulumtimit të parë në vitin 2015 dhe vitit 2020, u miratuan edhe Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (2020),³ ndryshimet në pjesën për krimet e urrejtjes në Kodin Penal (2018)⁴ dhe ndryshimet në Ligjin për Media Audio dhe Audiovizive (2018), të cilët tani përfshijnë orientimin seksual dhe identitetin gjinor si një kategori e mbrojtur.

Përparim të rëndësishëm paraqet edhe krijimi i Grupit parlamentar ndërpartiak për avancimin e të drejtave të LGBTI në prill të vitit 2018. Grupi është riformuar brenda përbërjes së re parlamentare 2020-2024 në mënyrë që të përfaqësojë nevojat e personave LGBTIQ me rastin e avancimit të kornizës ligjore në vend. Përparim në bashkëpunimin midis Kuvendit të RMV-së dhe organizatave LGBTIQ është arritur edhe me ofrimin e sallës së Kuvendit "Boris Trajkovski" për të mbajtur konferencën vjetore rajonale të Shoqatës për të Drejta të Barabarta të personave LGBTI nga Ballkani Perëndimor dhe Turqia.⁵

Gjatë vitit 2020, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale filloi procesin e hartimit të Planit Kombëtar për LGBTI 2021-2025, dhe në vitin 2021 Ministria e Arsimit filloi trajnimin e mësuesve për të zbatuar një program pilot për edukimin seksual gjithëpërfshirës⁶ dhe Qeveria miratoi një propozim ligj përgatitur nga Ministria e Drejtësisë për të ndryshuar Ligjin për Regjistrimin Amë në mënyrë që të mundësojë njohjen ligjore të gjinisë.⁷

Në maj 2020, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi për shkak të një gabimi procedural. Gjegjësisht, në vitin 2019 ligji ishte miratuar pa shumicën e kërkuar të përcaktuar me Kushtetutën e RMV-së. Në tetor 2020, ligji përsëri erdhi në rendin e ditës në Kuvend dhe u miratua nga 69 deputetë që votuan për ligjin.⁸ Ligji u

1 Ginova, B., 2018. *Raport mbi zbatimin e Rekomandimit CM / Rec (2010) 5 nga Komiteti i Ministrave drejtuar shteteve anëtare në lidhje me masat për të luftuar diskriminimin bazuar në orientimin seksual ose identitetin gjinor në Republikën e Maqedonisë. Shkup, Maqedoni: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i Republikës së Maqedonisë.*

2 Këshilli i Evropës, 2011. *Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.*

3 Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 258/2020.

4 Kodi Penal. "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 37/96, 80/99,4/2002, 43/2003, 19/2004, 81/2005, 60/2006, 73/2006, 7/2008, 139/2008, 114/2009, 51/11,135/11, 185/11, 142/12, 166/12, 55/13, 82/13, 14/14, 27/14, 28/14, 115/14, 132/14, 160/14, 199/14, 196/15, 226/15, 97/17 dhe 248/18.

5 <https://bit.ly/3hxVico>

6 <https://bit.ly/32xJka1>

7 <https://bit.ly/3bxmqV8>

8 <https://bit.ly/3sjv3rD>

miratua pa ndryshimin e nenit 18 i cili garantonte një procedurë transparente për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithëse u bë një zgjedhje transparente e komisionerëve, e gjithë procedura e miratimit, shfuqizimit dhe ri-miratimit të Ligjit (pa nenin 18), kontribuoi në forcimin e pasigurisë ligjore për personat LGBTIQ në RMV-së. .

Periodha midis dy hulumtimeve u shënuar nga organizimi i Paradës së Parë të Krenarisë në qershor të vitit 2019. Parada u ndoq nga një numër i madh i njerëzve dhe aktivistëve LGBTIQ, mbështetës nga vendi dhe rajoni, media si dhe përfaqësues të legjislativit dhe ekzekutivit. Përveç aktivistëve LGBTIQ, gjatë Paradës, në mbështetje të eventit u mbajtën fjalime edhe nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale dhe Koordinatori i Grupit Parlamentar Ndërpartiak për Avancimin e të Drejtave të njerëzve LGBTIQ në kuadër të Kuvendit të RMV-së.

Megjithëse kuadri ligjor ka bërë përparim të konsiderueshëm vitet e fundit, njerëzit LGBTIQ ende përballen me probleme të shumta të stigmës, diskriminimit dhe dhunës që kalojnë pa ndonjë verdikt ligjor. Aktet më të zakonshme të urrejtjes - gjashtë sulmet ndaj Qendrës për mbështetje LGBTIQ - nuk janë zgjidhur ende. E njëjta gjë ndodh edhe me sulmet ndaj anëtarëve individualë të komuniteteve LGBTIQ. Fakti që aktet e urrejtjes për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor nuk marrin zgjidhje ligjore kontribuon më tej në rritjen e mosbesimit ndaj institucioneve. Përveç kësaj, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Punëve të Brendshme nuk kanë futur ende sisteme për dokumentimin e krimeve të urrejtjes dhe monitorimin e tyre në baza të ndryshme, përfshirë orientimin seksual dhe identitetin gjinor, të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e programeve të tyre për menaxhimin e veprave penale nga urrejtja dhe rritjen e besimit se ata do të mbrojnë njerëzit LGBTIQ kur është e nevojshme.

Hulumtimet e fundit të kryera nga Banka Botërore (2018) dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (2020) tregojnë se shumica e njerëzve LGBTIQ në RMV nuk flasin publikisht për orientimin e tyre seksual, identitetin gjinor dhe shprehjen ose karakteristikat gjinore, janë të ekspozuar ndaj dhunës dhe diskriminimit dhe nuk kanë besim në institucionet se do t'i mbrojnë në rast të ndonjë nevojë. Hulumtimet tregojnë se kategoritë më të prekura janë personat transgjinorë dhe interseksualë. Kjo reflektohet edhe në kornizën ligjore, e cila në asnjë ligj nuk përfshin karakteristikat gjinore si kategori e mbrojtur, nuk përfshin një zgjidhje ligjore për njohjen ligjore të gjinisë dhe nuk njih shëndetin trans-specifik në listën pozitive të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Ky hulumtim, i cili u përqëndrua në perceptimin e njerëzve LGBTIQ për diskriminimin dhe dhunën me rastin e aksesit në shërbime sociale, punësim dhe arsim, shërbime ligjore dhe veprime nga autoritete policore, siguroi të dhëna që mund të përdoren nga organizatat LGBTIQ, por edhe institucionet publike në drejtim të përmirësimit të kornizës ligjore, forcimit të kapaciteteve të institucioneve dhe sigurimit të aksesit në informacion, në mënyrë që të lehtësohet realizimi i të drejtave të njeriut të personave LGBTIQ.

2.1. Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi i hulumtimit është të identifikojë pengesat dhe sfidat me të cilat përballen personat LGBTIQ në Republikën e Maqedonisë së Veriut në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre njerëzore, si dhe identifikimin e progresit ose regresit në krahasim me vitin 2015. Ky hulumtim

është pjesa e dytë e hulumtimit të kryer në vitin 2015,⁹ dhe shqyrton përvojat e personave LGBTIQ në qasjen në mbrojtjen dhe parandalimin e diskriminimit, shërbimet sociale, përvojat e dhunës, përfshirë dhunën në familje, mbrojtjen institucionale, trajtimin policor dhe aksesin në mbrojtjen nga policia. Midis vitit 2015 dhe 2020, organizatat LGBTIQ në vend raportuan shkelje të të drejtave të komuniteteve LGBTIQ në zonat që nuk mbulohen nga hulumtimi i vitit 2015, të tilla si aksesin në shërbimet shëndetësore dhe qasja në arsim. Prandaj, ky hulumtim përfshiu pyetje për këto fusha në pjesën e diskriminimit. Pjesa e qasjes në shëndetësi siguroi dokumentacionin e përvojave të njerëzve LGBTIQ në shërbimet e përgjithshme shëndetësore, si dhe aksesin në shërbimet shëndetësore trans-specifike dhe qasjen në shërbimet gjinekologjike specifike për gratë trans, burrat trans, njerëzit jo binarë dhe interseksualë që kanë nevojë për ekzaminime gjinekologjike. анс-мажи, Јобинарни и интерсекс луѓе, кои имаат потреба од гиЈоколошки прегледи.

⁹ Andonovski K., Bojanovska D., Bogoevski P., Gelevska A., 2015. Analiza e problemeve dhe nevojave të personave LGBTI në Republikën e Maqedonisë (në fushën e mbrojtjes sociale, shërbimeve juridike dhe veprimeve policore). Qendra për mbështetje LGBTI.

3

METODOLOGJIA

Metodologjia për këtë hulumtim u bazua në mbledhjen dhe analizën e të dhënave parësore dhe dytësore. Metodologjia kryesore e mbledhjes së të dhënave parësore është projektuar për të aplikuar një qasje metodologjike të kombinuar duke përdorur metoda sasiore dhe cilësore. Vëmendje e veçantë iu kushtua krijimit të një hapësire konfidenciale dhe të sigurt për mbledhjen e të dhënave përmes përdorimit të të ashtuquajturit hulumtim i bashkëmoshatarëve. Metodologjia e përdorur mundëson një rishikim krahasues të gjetjeve nga viti 2015 dhe 2020 në mënyrë që të kuptohet më mirë progresi ose regresi në realizimin e të drejtave të njeriut të personave LGBTIQ në RMV. Analiza e të dhënave dytësore përfshinte të dhënat e arkivuara nga hulumtimi i vitit 2015, korniza ekzistuese ligjore dhe nga një vështrim i literaturës.

3.1. Të dhënat dytësore

Analiza e të dhënave dytësore është kryer mbi të dhënat e disponueshme për gjendjen e personave LGBTIQ në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Kjo përfshin kryesisht një raport hulumtimi të kryer në vitin 2015 nga Qendra për mbështetje LGBTI, por u zgjerua me raportet e publikuara nga Banka Botërore (2018),¹⁰ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (2020)¹¹ Raporti për LGBTI dhe Zgjerimin e BE-së (2021).¹²

Për të rishikuar kornizën ligjore dhe institucionale për mundësimin e qasjes në të drejtat e njeriut për personat LGBTIQ, si dhe për të qenë në gjendje të identifikojnë rekomandimet më të përshtatshme, u krye një analizë thelbësore e kornizës ligjore. Disa nga ligjet që u rishikuan përfshijnë Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, Kodin Penal, Ligjin për Media Audio dhe Audiovizive dhe Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.

3.2. Të dhënat parësore

3.2.1. Pyetësi

Pyetësi (Shtojca 1) që u përdor për të mbledhur të dhëna brenda këtij hulumtimi përfshiu pyetje që u organizuan në katër grupe: a) aksesin në mbrojtjen sociale, b) diskriminimi në aksesin e kujdesit shëndetësor, arsimit dhe punësimit, c) dhuna dhe dhuna në familje dhe d) veprimi i policisë.

¹⁰ World Bank Group, 2018. *Life on the Margins: Survey Results of the Experiences of LGBTI People in Southeastern Europe*. World Bank. Available at: <https://bit.ly/3ga6PxM>.

¹¹ FRA (European Union Agency for Fundamental Rights), 2020. *A Long Way to Go for LGBTI Equality*. European Union Agency for Fundamental Rights. Available at: <https://bit.ly/3x98rxZ>

¹² <https://bit.ly/3h6UoDo>

Pjesa mbi aksesin në mbrojtjen sociale përfshiu pyetje në lidhje me përvojat me përdorimin e shërbimeve sociale në komunitet dhe institucione, përvojat e diskriminimit dhe përvojat në raportimin e rasteve të diskriminimit. Në pjesën për diskriminimin në aksesin në kujdesin shëndetësor, arsimin dhe punësimin, përveç çështjeve të diskriminimit të perceptuar dhe raportimit të rasteve të diskriminimit, u përfshinë edhe pyetje për qasjen të një gjinekolog dhe shërbimet shëndetësore trans-specifike. Në pjesën për dhunën dhe dhunën në familje, në bëmë një përpjekje për të kuptuar përvojat e njerëzve që kanë mbijetuar nga lloje të ndryshme të dhunës, si dhe përvojat e tyre në raportimin e këtyre rasteve tek institucionet publike dhe organizatat joqeveritare.

Pyetjet sa i përket veprimit të policisë u organizuan në pesë nëngrupe: veprimi i policisë ndaj personave LGBTIQ, trajtimi policor i viktimave LGBTIQ, përdorimi i forcës së pabazuar dhe të tepruar nga punonjësit e policisë kundër personave LGBTIQ, raportimi i rasteve të përdorimit të forcës së pabazuar dhe të tepruar nga oficerët e policisë dhe besimi te personat LGBTIQ se policia do t'i mbrojë kur të kenë nevojë.

Pyetësi përfshinte pyetje të mbyllura dhe të hapura. Pyetjeve të mbyllura iu përgjigjën bazuar në opsionet e ofruara të përgjigjeve. Kështu, te pyetjet e mbyllura kishte një mundësi për vlerësim të shkallëzuar, përgjigje duke zgjedhur një opsion ose përgjigje duke zgjedhur më shumë opsione. Pyetjet e hapura që ishin pjesë e pyetësorit ofrojnë një mundësi për të kuptuar më të thellë përvojat e njerëzve LGBTIQ.

Pyetësi që kemi përdorur për këtë hulumtim bazohet në atë të përdorur në vitin 2015, por i zgjeruar për kategoritë: qasja në shërbimet shëndetësore dhe qasja në arsim, në mënyrë që të mblidhen të dhënat aktuale mbi diskriminimin e perceptuar nga personat LGBTIQ si dhe përvojat e tyre sa i përket raportimit të rasteve të diskriminimit edhe në këto fusha. Ne konsideruam se këto të dhëna mund të përdoren nga institucionet publike dhe organizatat joqeveritare në krijimin ose avokimin e politikave publike, si dhe në zhvillimin e programeve të punës.

3.2.2. Mbledhja e të dhënave

Qasja metodologjike për mbledhjen e të dhënave u bazua në të ashtuquajturën qasje hulumtuese nga bashkëmoshatarë (peer research approach). Kjo përfshinte intervista sy më sy në të cilat hulumtimi i meshkujve homoseksualë dhe biseksualë u krye nga burra gay dhe biseksualë, midis grave LBK nga gra LBK, dhe midis personave trans dhe personave jo binarë gjinorë nga këto komunitete. Kjo metodë ju lejon të zvogëloni objektivizimin e pjesëmarrësve në hulumtim, duke i lejuar ata të udhëheqin procesin duke marrë përgjegjësinë për mënyrën se si do të mblidhen të dhënat. Për më tepër, ky proces siguron një hapësirë të sigurt për pjesëmarrësit në hulumtim që të përdorin gjuhën dhe terminologjinë të afërt me (nën)kulturën e tyre në vend të "qëndrimeve të pranueshme shoqërore" që shpesh ndodhin në hulumtimet sy më sy. Përveç lejimit të pjesëmarrësve të ndajnë përvojat e tyre në një mjedis të sigurt, ky proces shërbeu gjithashtu për të forcuar kapacitetin e vetë hulumtuesve që kishin ndjekur më parë trajnimin. Trajnimi për hulumtuesit bashkëmoshatarë përbëhej nga dy pjesë. Pjesa e parë kishte për qëllim njohjen me përmbajtjen e pyetësorit për t'u siguruar që hulumtuesit i kuptojnë mirë pyetjet dhe mund t'i përcjellin dhe shpjegojnë qartë ato të anketuarit e tyre

nëse është e nevojshme. Pjesa e dytë e trajnimit iu kushtua mënyrës sesi duhet të vepronë hulumtuesit në rast të situatave të vështira emocionale, të cilat pritet të ndodhin gjatë intervistave dhe si në raste të tilla të drejtojnë bashkëbiseduesit e tyre në shërbimet e disponueshme për mbështetje psiko-sociale dhe/ose këshillime juridike. Si një aspekt tjetër i hulumtimit nga bashkëmoshatarë, gjatë trajnimit, intervistuesit patën mundësinë të marrin pjesë në finalizimin e përmbajtjes së pyetësorit. Para fillimit të anketimit, pyetësori u pilotua dhe u testua në mesin e njëmbëdhjetë anketuesve.

Gjatë krijimit të metodologjisë së hulumtimit në vitin 2015, ekipi hulumtues vendosi të përfshijë një mostër të mundshme të popullsisë totale të LGBTI, duke përfshirë vetëm ato qytete ku kishte bërthama aktivistësh të njerëzve LGBTI, me të cilët Qendra kishte krijuar komunikime. Për këtë qëllim, ata shpërndanë 20 pyetësorë në secilën prej këtyre komunave. Për të ruajtur mundësinë e analizës krahasuese, të njëjtat qytete u përfshinë përsëri. Këto qytete janë Shkupi (plus Komuna e Shuto Orizarës), Tetova, Kumanova, Manastiri, Strumica dhe Prilepi. Duke marrë parasysh se disa nga bërthamat aktiviste funksionojnë në mënyrë të pavarur nga Qendra për mbështetje LGBTI, dhe disa nuk janë më në funksion, këtë herë hulumtimi u krye në territorin e gjithë vendit. Mbledhja e të dhënave u krye në periudhën midis 19 nëntorit 2020 dhe 10 janarit 2021. U mblodhën gjithsej 217 pyetësorë të plotësuar nga 25 vendbanime të vendit tonë.

Të gjithë të anketuarve iu dha një kompensim bruto prej 615 denarë për pjesëmarrjen e tyre në hulumtim, në mënyrë që të siguronin një kompensim simbolik për kohën që kaluan duke iu përgjigjur pyetësorit, veçanërisht duke pasur parasysh se personat LGBTIQ ishin më të prekurit financiarisht nga efektet e pandemisë me Covid-19.

Para fillimit të mbledhjes së të dhënave, intervistuesit morën një Udhërrëfyes për zbatimin e intervistës që përmbante udhëzimet kryesore të prezantuara gjatë trajnimit, një listë përkufizimesh të termave kryesorë të përdorur në hulumtim dhe një listë të organizatave që ofrojnë mbështetje për personat LGBTIQ, si dhe kontaktet e tyre në rast se kishte nevojë për cilindo nga të anketuarit.

2.2.2.1. Dallimet në qasje në krahasim me hulumtimin e vitit 2015

Edhe pse qasja metodologjike bazohet në metodologjinë e përdorur në vitin 2015, megjithatë u bënë disa kufizime sa i përket krahasueshmërisë së rezultateve të këtij hulumtimi:

- **Ndryshimi i qyteteve:** Në vitin 2015, në Qendra për mbështetje LGBTI funksiononin bërthama aktiviste në Shkup (plus në Komunën e Shuto Orizarës), Tetovë, Kumanovë, Manastir, Strumicë dhe Prilep, qytete ku u ybatua hulumtimi. Në vitin 2020, disa nga këto bërthama nuk ishin më aktive, kështu që hulumtimi u zgjerua në territorin e gjithë vendit. Për më tepër, pyetësori i përdorur në vitin 2020 nuk siguroi një pasqyrë të qartë se sa pjesëmarrës vijnë nga Komuna e Shuto Orizarit sepse të gjithë ishin të regjistruar nën opsionin "Shkup".
- **Devijimet nga mbledhja e të dhënave nga bashkëmoshatarët:** Disa nga intervistuesit regjistruan devijime nga mbledhja e të dhënave nga bashkëmoshatarët, por vetëm

në kushtet kur i intervistuari dhe intervistuesi tashmë kishin krijuar një marrëdhënie konfidenciale. Devijimet e regjistruara nuk ishin më shumë se 10% e mostrës totale të hulumtimit.

- **Lista e zgjeruar e arsyeve për mos raportimin e një rasti diskriminimi ose dhune:** Në vitin 2015, për të kuptuar arsyet pse të anketuarit nuk raportuan raste diskriminimi ose dhune, ndër të tjera, ishte ofruar edhe opsioni: 'besoj se do të kem pasoja të dëmshme nëse e raportoj rastin'. Për të marrë një pasqyrë më të qartë, në vitin 2020 këtë opsion e ndamë në tri pjesë: 'frika për sigurinë time', 'frika nga zbulimi i orientimit tim seksual dhe/ose identitetit gjinor' dhe 'frika nga dënimi dhe paragjykimi nga rrethina më e afërt'. Gjatë analizës krahasuese, ky fakt u mor parasysh gjithashtu.

2.2.2.2. Kufizime të tjera metodologjike

Përveç kufizimeve të përmendura në kontekstin e krahasueshmërisë së gjetjeve, kufizimet e tjera të hulumtimit përfshijnë:

- **Të dhënat u mblodhën vetëm në gjuhën maqedonase:** Për shkak të pamundësisë për të angazhuar intervistues që flasin gjuhët e të gjitha grupeve etnike, si dhe për shkak të kufizimeve financiare për të organizuar përkthimin e pyetësorit në ato gjuhë, hulumtimi u krye në gjuhën maqedonase.
- **Përfaqësimi i mostrës sipas përkatësisë etnike dhe bazave të tjera:** Mostra për këtë hulumtim nuk ofron një raport të barabartë midis përfaqësuesve të grupeve të ndryshme sipas shifrave nga regjistrimi i fundit i vitit 2002 në RMV.

2.2.3. Mostra e hulumtimit dhe të dhënat demografike

Hulumtimi është kryer në mesin e 217 të anketuarve nga i gjithë territori i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Duke pasur parasysh kontekstin në RMV, është e vështirë të kontaktosh me njerëzit LGBTIQ të cilët janë të hapur për orientimin e tyre seksual, identitetin dhe shprehjen e tyre gjinore. E nevojshme ishte të sigurohej një mundësi për t'i angazhuar mbi baza vullnetare në hulumtim. Kështu, mostra u përzgjedh nga intervistuesit me rekomandimin e të anketuarve. Ky hulumtim nuk është bërë në një mostër përfaqësuese për dy arsye kryesore. Është pothuajse e pamundur të kuptohet numri total i personave LGBTIQ në vend¹³ nga njëra anë dhe nga ana tjetër, nevoja e madhe për mbrojtjen e privatësisë nga personat LGBTIQ për shkak të stigmës dhe homo/trans/bi/ lezbo/interfobisë në vend. Prandaj, ky hulumtim nuk përpiket të tregojë gjendjen e të gjithë personave LGBTIQ në vend përse i përket aksesit në të drejtat dhe shërbimet, por të paraqesë përvojat e mostrës së përdorur në këtë hulumtim. Hulumtimi u krye në mesin e të anketuarve nga i gjithë territori i RMV-së, duke përfshirë mosha të ndryshme, bashkësi etnike, mjedise sociale. Shpërndarja e të anketuarve sipas vendbanimit është treguar në Tabelën 1.

¹³ Enti i Statistikës nuk mblodh të dhëna të tilla, kështu që as madhësia dhe as karakteristikat e popullsisë nuk dihen, gjë që e bën të pamundur krijimin e një mostre përfaqësuese. <https://bit.ly/3bwIhNB>

Tabela 1:

Persona LGBTIQ të anketuar sipas vendbanimit

	Numri i të anketuarve	Përqindja
Manastir	20	9,22 %
Veles	8	3,69 %
Gjevgjeli	7	3,23 %
Gostivar	3	1,38 %
Kavadar	6	2,76 %
Kërçovë	4	1,84 %
Koçanë	1	0,46 %
Kriva Pallankë	1	0,46 %
Kumanovë	7	3,23 %
Negotinë	2	0,92 %
Ohër	6	2,76 %
Prilep	8	3,69 %
Radovish	2	0,92 %
Resnjë	6	2,76 %
Shkup	101	46,54 %
Strugë	7	3,23 %
Strumicë	12	5,53 %
Tetovë	9	4,15 %
Shtip	7	3,23 %
Gjithsej	217	100,00 %

Të dhënat demografike të të anketuarve janë si më poshtë:

- **Gjinia:** Numri më i madh i të anketuarve janë identifikuar si femra (49.31%), krahasuar me meshkujt (43.32%) dhe jo binarë (5.53%). Një përqindje më e vogël e të anketuarve kanë konfirmuar opsionin për diçka tjetër (1.84%), duke u deklaruar si “queer”, “fluid” dhe “genderfax”.
- **Mosha:** Mosha mesatare e të anketuarve është 27.07 vjeç, kurse vetëm 3.22% e të anketuarve janë mbi 45 vjeç.
- **Të anketuarit transgjjinorë:** Nga të gjithë të anketuarit, 18 (8.29%) identifikohen si transgjjinorë.
- **Të anketuarit interseks:** Nga të gjithë të anketuarit, vetëm një person deklaroi se identifikohet si interseks, ndërsa dy persona deklaruan se nuk duan të përgjigjen.
- **Paaftësia/Pengesa:** Nga të gjithë të anketuarit, 17 (7.83%) deklaruan se kanë pengesa.
- **Përkatësia e etnike:** Shumica e të anketuarve janë anëtarë të bashkësisë etnike maqedonase (81.57%), pjesa tjetër janë shqiptarë (7.37%), romë (3.23%), serbë (1.38%), turq (1.38%). Dy të anketuar deklaruan se janë nga bashkësia etnike vllahe, një i anketuar deklaroi se ai është maqedonas - hebre, një e anketuar kroate maqedonase dhe një i anketuar malazez.

- **Gjendja socio-ekonomike:** Pothuajse dy të tretat e të anketuarve, sipas perceptimit personal, i përkasin shtresës së mesme socio-ekonomike (64.98%), dhe pak më shumë se një e katërta i përkasin klasës punëtore (26.73%). Një pjesë e vogël e të anketuarve konsiderojnë se i përkasin një shtrese më të lartë (3.23%).
- **Orientimi seksual:** Më shumë se një e treta e të anketuarve identifikohen si homoseksualë (34.56%). Biseksualë ishin 29.95% dhe lezbike 24.42%. Të tjerët u identifikuan si queer, panseksualë, heteroseksualë dhe aseksualë.
 - Shumica e të anketuarve nuk flasin hapur për orientimin e tyre seksual me askënd përveç miqve të tyre më të ngushtë (54.76%). Një në dhjetë të anketuar flasin për orientimin e tyre seksual në mjedisin arsimor ose të punës (11.56%), me anëtarët më të afërt të familjes (9.18%) ose me të gjithë personat e mjedisit ku jetojnë (11.22%).

Tabela 2:
Persona të anketuar LGBTIQ sipas gjinisë dhe orientimit seksual

Gjinia ¹⁴	Mashkullore	Femërore	Jo binare
Orientimi seksual			
Gay	71	1	2
Lezbike		50	3
Biseksual/e	17	44	4
Heteroseksual/e	1	8	
Aseksual/e	1	0	
Tjetër	4	4	3

¹⁴ Termi gjini në këtë kontekst është një term gjithëpërfshirës që përfshin të intervistuarit cisgjnorë dhe transgjnorë.

4.1. Qasja në mbrojtjen sociale

Gjetjet kryesore

- 17.92% ishin diskriminuar me rastin e shfrytëzimit të drejtave nga fusha e mbrojtjes sociale, dhe 84.44% prej tyre nuk kishin raportuar diskriminim;
 - 12.50% e të anketuarve ishin përballur me diskriminim me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve sociale në bashkësinë lokale;
 - 56.67% e të anketuarve kishin shprehur pakënaqësi me qëndrimin e shërbimit kompetent me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve nga fusha e mbrojtjes sociale;
 - Asnjë nga të anketuarit që kishte përjetuar diskriminim me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve sociale në bashkësinë lokale, në një institucion ose në ndonjë shërbim kompetent nuk e kishte raportuar rastin në ndonjë institucion ose organizatë përkatëse.
-

Për të kuptuar më mirë përvojat e njerëzve LGBTIQ sa i përket qasjes në shërbimet e mbrojtjes sociale, pyetëtori përfshinte trembëdhjetë pyetje që mbulonin temat e diskriminimit, qasjen në shërbimet sociale në komunitetin lokal dhe qasjen në shërbimet sociale në një institucion.

Grupi i parë i pyetjeve në fushën e mbrojtjes sociale i referohet përvojave të diskriminimit të komunitetit LGBTIQ në procesin e ushtrimit të të drejtave nga mbrojtja sociale (parandalimi social, ndihma financiare sociale, e drejta për strehim social, ndihma financiare e njëhershme ose ndihma materiale) dhe raportimin e diskriminimit në institucionet kompetente.

Kjo kategori nuk përfshin çështjet e qasjes në kujdesin shëndetësor, siç ishte rasti në hulumtimin e vitit 2015. Për të siguruar një pasqyrë më të mirë të përvojave të personave LGBTIQ, çështjet rreth qasjes në kujdesin shëndetësor trajtohen në një kategori të veçantë.

Sipas përgjigjeve të marra nga pjesëmarrësit, 82.08% u përgjigjën se nuk ishin të diskriminuar në përdorimin e të drejtave nga mbrojtja sociale, ndërsa 17.92% ishin të diskriminuar në përdorimin e të drejtave të mbrojtjes sociale (Diagrami 1).


4

GJETJET NGA HULUMTIMI



Diagrami 1:


Diskriminimi ndaj personave LGBTIQ gjatë ushtrimit të të drejtave të mbrojtjes sociale



Nga ata që ishin diskriminuar në përdorimin e të drejtave të mbrojtjes sociale, 84.44% u përgjigjën se nuk kishin raportuar diskriminim, 6.67% kishin raportuar në OJQ, dhe 4.44% në polici ose Sektorin e kontrollit të brendshëm pranë MPB-së. Vetëm nga një person kishte raportuar në Qendrën për Punë Sociale dhe Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Diagrami 2).

Diagrami 2:


Raportimi i përvojave të diskriminimit në ushtrimin e të drejtave të mbrojtjes sociale në një institucion shtetëror ose organizatë kompetente



Gjetjet e analizës tregojnë se përvojat e diskriminimit në komunitetin LGBTIQ nuk raportohen. Nga të gjithë të anketuarit që nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit, 43.24% thanë se arsyeja për këtë ishte mosbesimi se institucionet do ta zgjidhnin rastin. Një përqindje e konsiderueshme e të anketuarve (24.33%) kishin frikë se raportimi i rastit do të kishte pasoja negative për ta (frika për sigurinë e tyre - 8.11%, frika nga zbulimi i orientimit seksual ose identitetit gjinor nga zyrtarët - 8.11%, frika nga dënimi dhe paragjykimet nga mjedisi - 8.11%). Rezultatet e hulumtimit dokumentojnë mosbesimin që komunitetet LGBTIQ kanë në institucione, si dhe frikën për sigurinë e tyre. Një numër i vogël i të anketuarve (2.70%) u përgjigjën se arsyeja e mos raportimit ishte se ata ndiheshin të rehatshëm që të bisedonin me nëpunësit civilë për orientimin e tyre seksual ose identitetin gjinor (Diagrami 3).

Diagrami 3:

Nëse nuk e keni raportuar rastin e diskriminimit gjatë ushtrimit të të drejtave të mbrojtjes sociale, cilat janë arsyet që nuk e keni raportuar?




Të anketuarve iu dha mundësia të zgjedhin më shumë përgjigje nga lista e shërbimeve të komunitetit. Sipas gjetjeve të hulumtimit, më të përdorurat janë shërbimet e transportit (25.17%), spitalet ditore (9.73%) dhe qendrat e shëndetit mendor (8.05%). Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (8.39%) deklaruan se edhe pse kishin nevojë për to, ata nuk i kishin përdorur shërbimet sociale të komunitetit (Diagrami 4).

Gjetjet tregojnë se 12.50% e të anketuarve u përballën me diskriminim me rastin e përdorimit të shërbimeve sociale në bashkësinë lokale.

Diagrami 4:


Qasja në shërbimet sociale të bashkësisë lokale .



Përqindja e atyre që kanë përdorur shërbime në një institucion është 8.14% (Diagrami 5), për këtë shkak perceptimi për diskriminim është shumë i ulët (1.80%).

Diagrami 5:


Qasja në shërbimet sociale të institucioneve



Pyetësi gjithashtu shqyrton qëndrimin e shërbimit profesional me rastin e përdorimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale. Kështu, 43.33% ishin të kënaqur, kurse 56.67% e të anketuarve shprehën pakënaqësi me qëndrimin e shërbimit profesional me rastin e përdorimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale - shërbimet sociale si në institucion ashtu edhe në bashkësinë lokale (Diagrami 6).

Diagrami 6:

A jeni të kënaqur me sjelljen e shërbimit profesional me rastin e përdorimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale (në institucion dhe në bashkësinë lokale)?




Arsyet më të zakonshme të pakënaqësisë me sjelljen e shërbimit profesional (Diagrami 7) ishin këto: veprim i vonuar dhe/ose joefikas (38.78%), sjellje e papërshtatshme e punonjësve për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të të anketuarve (26.53 %), diskriminimi për shkak të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të të anketuarve (16.33%). Ata të anketuar që zgjedhën opsionin "tjetër" (18.37%) ndanë përvojat e tyre që përfshijnë:

- 1 Diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike;
- 2 Stigmatizimin për shkak të shprehjes gjinore, pamjes dhe mënyrës së veshjes;
- 3 Ngacmimin seksual nga personeli teknik mjekësor;
- 4 Sjelljet përgjithësisht vulgare, të pahijshme dhe joprofesionale që nuk kanë lidhje me orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor të të anketuarve;
- 5 Paragjykimin dhe mungesën e informacionit nga ana e shërbimit kompetent;

Diagrami 7:

Vërejtje mbi sjelljen e shërbimit profesional me rastin e përdorimit të shërbimeve të mbrojtjes sociale (në institucion dhe në bashkësinë lokale).




Është shqetësues fakti që asnjë nga të anketuarit që kanë përjetuar diskriminim me rastin e përdorimit të shërbimeve sociale në bashkësinë lokale, në një institucion ose nga shërbimi kompetent nuk e kanë raportuar rastin në ndonjë institucion apo organizatë përkatëse. Mosbesimi se institucionet do ta zgjidhin rastin (38.46%) është arsyeja kryesore pse dy nga pesë të anketuarit nuk e kanë raportuar rastin, ndërsa për gati një të tretën e të anketuarve

(28.72%) është frika që raportimi i rastit të diskriminimi do të ketë pasoja të dëmshme për ta: frika për sigurinë e tyre (7.69%), frika e zbulimit të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të të anketuarve nga oficerët (11.54%), dhe frika e dënimit dhe paragjykit nga rrethina e afërt e personit të anketuar (7.69%). Çdo i dhjeti i anketuar (11.54%) ka pasur siklet të komunikojë me nëpunësit civilë për orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor, dhe 15.38% e të anketuarve nuk kanë pasur njohuri se ku duhej ta raportonin rastin (Diagrami 8).

Diagrami 8:

Cilat janë arsyet për mos raportimin e rastit të diskriminimit në përdorimin e të drejtave të mbrojtjes sociale (në një institucion dhe në një bashkësi lokale)?



4.1.1. Rekomandimet e komunitetit

Pjesëmarrësit në hulumtim u pyetën për pikëpamjet dhe rekomandimet e tyre për përmirësimin ose lehtësimin e aksesit në shërbimet sociale për personat LGBTIQ. Prëfimet e tyre mund të kategorizohen në pesë grupe:

A. Edukimi i nëpunësve për të punuar me persona LGBTIQ

1. Të edukohen nëpunësit kompetentë rreth personave LGBTI dhe nevojave të tyre;
2. Edukimi i nëpunësve për të mos diskriminuar personat LGBTI;
3. Të investohen më shumë burime për shërbimet sociale dhe edukimin e punonjësve;
4. Punonjësit e këtyre institucioneve të arsimohen për çështjet LGBTI dhe "të mësojnë se ne nuk jetojmë të gjithë në një utopi cis-hetero".
5. Punëtorët në këto institucione sociale duhet të njihen me termat e personave LGBTI dhe të arsimohen më shumë për ato tema;
6. Të sensibilizohet stafi që punon në qendrat që ofrojnë shërbime sociale;
7. Të organizohen punëtori nga organizatat e shërbimeve që ofruerit e shërbimeve të jenë më të ndjeshëm/kujdesshëm kur bëhet fjalë për personat LGBTI.

B. Avancimi dhe zbatimi i kornizës ligjore

8. Ajo që nevojitet është që të funksionojë ligji për diskriminimin dhe që të ketë një komision objektiv dhe të shpejtë për diskriminim. Zgjidhja e rasteve të diskriminimit në institucionet sociale në dobi të personave LGBTI do të rrisë ndërgjegjësimin e nëpunësve që të kenë kujdes se si veprojnë. Sigurisht në vendin tonë, në Maqedoni, vetëm sanksionet mund të bëjnë ndryshimin. Kjo natyrisht do të ishte vetëm

sipërfaqësore, por disi mendoj se pranimi i vërtetë i njerëzve LGBTI në Maqedoni është larg i mundshëm për momentin;

9. Institucionet duhet të ndjekin ligjin e ri kundër diskriminimit dhe të paktën të mos diskriminojnë në mënyrë aktive. Problemi i ryshfetit dhe korrupsionit duhet të adresohet dhe më shumë inspektorë duhet të kontrollojnë se si funksionojnë këto institucione në mënyrë që diskriminimi të mos bëhet fenomen i zakonshëm;
10. Të sigurohen të drejta të barabarta për personat LGBTI si për të gjithë të tjerët;
11. Të përmirësohet korniza ligjore për të siguruar të drejtën për shërbime sociale për personat LGBTI dhe që ata të mos refuzohen;
- 12.

C. Ndryshimet strukturore për të lehtësuar aksesin në shërbimet sociale

13. Të punësohen njerëz nga komuniteti LGBTI në vetë shërbimet/institucionet sepse ata do t'i kuptonin më së miri nevojat e komunitetit;
14. Të ekzistojnë qendra të sigurta në të gjitha qytetet e vogla;
15. Të punësohet një psikolog ose punonjës social për të punuar me komunitetin LGBTI;
16. Të sigurohet akses më i madh në shërbime, me mundësi për qasje online;
17. Të vendoset staf profesional sepse tani personat LGBTI kanë frikë t'i përdorin këto shërbime;
18. Mund të ketë një shenjë se ai institucion është OK/miqësor me personat LGBTI, dmth që do t'i ndihmojë këta njerëz në mënyrën më të duhur (si një shërbim i certifikuar, diçka e tillë);
19. Të punësohen njerëz të arsimuar në institucionet për mbrojtje sociale të cilët do të njohin çështjen LGBTI dhe do të jenë ndërmjetës midis institucioneve dhe komunitetit;
20. Institucionet sociale duhet të deklarojnë publikisht se janë aleatë të komunitetit LGBTI në mënyrë që njerëzit queer të mos kenë nevojë të fshehin identitetet e tyre nga nëpunësit;
21. Të sigurohet një mbështetje më e mirë psikologjike për njerëzit LGBTI, të sigurohet një psikolog familjar për personat LGBTI;
22. Të ofrohet siguri më e madhe për personat LGBTI sa i përket qasjes në shërbimet sociale;
23. Njerëzit që kanë atë profesion (që ofrojnë shërbime sociale) duhet të bëjnë një test para se të marrin atë punë. Të jesh mendjehapur në mënyrë që të mos ofendosh njerëzit që kërkojnë ndihmë;
24. Kontroll më i rreptë nga lart-poshtë i administratës që ofron shërbime sociale. Ndëshkimi i punonjësve që diskriminojnë personat LGBTI;
25. Duhet të futet edukimi gjithëpërfshirës seksual dhe të normalizohet ekzistenca e personave LGBTI;
26. Të gjendet një mënyrë për të motivuar punonjësit në shërbimet sociale, për të ofruar shërbime më të mira, për të reduktuar qëndrimin heteronormativ të përqindjes më të madhe të punonjësve;

- 27. Të hulumtohet se deri në çfarë mase ekziston homofobia/transfobia në institucione, për të parë se si realisht mund të zbatohen politika për të mbështetur personat LGBTI;
- 28. Të përmirësohet infrastruktura në shkallë vendi, të përmirësohet fuqimisht në të gjitha institucionet shtetërore;
- 29. Të prezantohen masa të veprimit afirmativ për personat LGBTI;
- 30. Të ketë departamente/sectorë speciale që do të merreshin vetëm me çështjet LGBTI;
- 31. Punë më efektive e shërbimeve sociale dhe më shumë fonde nga buxheti i shtetit për shërbimet sociale;
- 32. Më pak burokraci dhe efikasitet më të madh të sistemit të vlerësimit të përshtatshmërisë për njerëzit që kanë nevojë për ndihmë sociale.
- 33. Të ketë vende (OJQ/jashtë institucioneve) ku personat LGBTI do të ndiheshin më të sigurt/më pak të diskriminuar kur kërkojnë informacion në lidhje me shërbimet sociale;
- 34. Të hapet një Qendër për mbështetjen LGBTI në komunën time Shuto Orizari.

Ç. Përmirësimi i aksesit në informacion për shërbimet sociale

- 35. Të përmirësohet aksesit në informacionin për të mësuar se cilat shërbimet sociale ekzistojnë dhe janë të disponueshme;
- 36. Të dihet qartë se cilat shërbime sociale të marrin, të dihet një paketë shërbimesh për personat LGBTI, të krijohet kjo paketë, të lehtësohet aksesit në këtë paketë, veçanërisht për njerëzit që refuzohen nga familjet e tyre për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, për t'u dhënë atyre ndihmë të posaçme;
- 37. T'u kushtohet vëmendje personave LGBTI në qytetet më të vogla për të rritur ndërgjegjësimin mbi disponueshmërinë e këtyre shërbimeve në vendet e tyre të banimit;
- 38. Linja telefonike për informacion/ndihmë;
- 39. Më shumë informacion nga Qendrat për mbrojtje sociale të personave LGBTI;
- 40. Hapja e qendrave/pikave të informacionit për komunitetin LGBTI;
- 41. Mediat të ndihmojnë në informimin e komunitetit LGBTI në lidhje me këto shërbime sociale.

D. Rritja e ndërgjegjësimit publik

- 42. Fushata për pranimin e personave LGBTI;
- 43. Të normalizohen seksualitetet e ndryshme dhe identitetet gjinore;
- 44. Të ballafaqohet publiku me ekzistencën e njerëzve LGBTI dhe kështu të ketë qasje më të lehtë në informacion;
- 45. Pranimi i personave LGBTI, përmes promovimit të personave LGBTI dhe nevojave të tyre në rrjetet sociale.

4.2. Qasja në mbrojtjen shëndetësore

Gjetjet kryesore


- 14.55% e të anketuarve konsiderojnë se kanë qenë viktime të diskriminimit në procesin e marrjes së shërbimeve të kujdesit shëndetësor;
- 91.18% nuk e kanë raportuar rastin në ndonjë institucion apo organizatë përgjegjëse;
- 71.88% e të anketuarve nuk kanë ndarë informacion mbi orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor me gjinekologun e tyre;
- 38.46% e të anketuarve kanë përjetuar pyetje dhe komente të papërshtatshme, ngacmim ose diskriminim, ose një kombinim të këtyre kur kanë marrë shërbime të kujdesit shëndetësor parësor dhe dytësor për personat trans. 21.43% nuk kishin arritur të marrin shërbimet e nevojshme shëndetësore;

Qasja në kujdesin/mbrojtjen shëndetësor është pjesë e shërbimeve sociale. Por për të kuptuar më mirë përvojat e njerëzve LGBTIQ në aksesin në shëndetësi, në këtë hulumtim ne e shqyrtuam atë në mënyrë të ndarë. Pyetësi përfshinte gjithsej 19 pyetje në këtë pjesë. Nga këto, shtatë pyetje i referohen qasjes së përgjithshme në kujdesin shëndetësor, ndërsa gjashtë pyetje në mënyrë specifike i referohen grave cis, burrave trans, njerëzve jobinarëve dhe interseksualëve që kanë nevojë për ekzaminime gjinekologjike, dhe gjashtë pyetje adresojnë qasjen në kujdesin shëndetësor parësor dhe dytësor, ekzaminime specifike për procedurat e verifikimit gjinor.

Sipas gjetjeve të hulumtimit, 14.55% e të anketuarve konsiderojnë se kanë qenë viktime të diskriminimit në procesin e marrjes së kujdesit shëndetësor (Diagrami 9). Është shqetësuese që nga të gjithë ata që i mbijetuan diskriminimit, vetëm 3 persona (8.82%) e raportuan rastin, një prej të cilëve në Ministrinë e Shëndetësisë, një në një OJQ, dhe një person kishte komunikuar me mediat që mbulojnë këtë temë. Vetëm personi që raportoi rastin në një OJQ deklaroi se ishte jashtëzakonisht i kënaqur me qëndrimin e zyrtarëve në lidhje me orientimin e tij seksual dhe/ose identitetin gjinor. Ndërsa, dy të tjerët që raportuan përkatësisht në Ministrinë e Shëndetësisë dhe mediat përkatëse, deklaruan se në përvojën e tyre ata janë jashtëzakonisht të pakënaqur me qëndrimin e nëpunësve.

Diagrami 9:

A mendoni se keni qenë viktimë e diskriminimit në procesin e ushtrimit të të drejtave tuaja të kujdesit/mbrojtjes shëndetësor?




Ne i pyetëm ata të anketuar që të deklarorin arsyen se pse nuk mkishin raportuar rastin e diskriminimit në qasjen në kujdesin shëndetësor. Gjetjet nga përgjigjet e tyre (Grafiku 10) tregojnë se shumica e tyre nuk u besojnë institucioneve që do të zgjidhnin çështjen (35.48%) ose (35.49% kishin frikë se kjo mund të kishte pasoja të dëmshme për to), përfshirë frikën për sigurinë e tyre (9.68%), frikën e zbulimit të orientimit të tij seksual dhe/ose identitetit gjinor (9.68%) dhe frikën e dënimit dhe paragjykimit nga rrethina (16.13%). Një nga të anketuarit deklaroi se arsyeja e mos raportimit të rastit të diskriminimit ishte përvoja negative që ai kishte në të kaluarën kur kishte raportuar atëkohë një rast tjetër diskriminimi.

Një përqindje e konsiderueshme (14.71%) e atyre që u përballën me diskriminim në qasjen në shërbimet shëndetësore deklaruan se nuk e raportuan rastin sepse nuk e dinin se ku mund ta bënin.

Diagrami 10:

Cilat janë arsyet për mos raportimin e rastit të diskriminimit në procesin e ushtrimit të të drejtave të kujdesit shëndetësor?



4.2.1. Qasja në shërbimet gjinekologjike


Për të kuptuar më mirë përvojat me rastin e vizitës te gjinekologu/ja, ne krijuam një pjesë në pyetësor të destinuar vetëm për ata të anketuar (gjysma e mostrës totale të hulumtimit - 51.61%) që kanë nevojë për shërbime gjinekologjike. Pyetjet ishin të destinuara për gratë cis, burrat trans, njerëzit jo binarë dhe interseksualë që kanë nevojë për ekzaminime gjinekologjike. Gjetjet tregojnë se 14.29% e të anketuarve që kishin nevojë për trajtim gjinekologjik, nuk e kanë bërë ende këtë. Dy arsyt kryesore të cituara nga të anketuarit janë shmangia e përgjigjeve të pyetjeve në lidhje me partnerët e tyre seksualë dhe mungesën e guximit.

Shumica e të anketuarve (85.71%) kishin vizituar një klinikë gjinekologjike të paktën një herë në jetën e tyre. Nga këto, një përqindje më e vogël i përmbahen rekomandimeve për të vizituar një gjinekolog çdo gjashtë muaj (18.81%). Pothuajse një e treta e të anketuarve (27.72%) e bëjnë këtë një herë në vit, dhe 37.62% vizitojnë një gjinekolog vetëm kur është e nevojshme.

Për të kuptuar më mirë kontekstin, ne pyetëm të anketuarit nëse gjinekologët e tyre të kujdesit parësor ishin të njohur me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor. Gjetjet treguan se dy nga tre të anketuar (71.88%) nuk ndanë informacion në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor (Grafiku 11).

Diagrami 11:

A është doktori i njohur me orientimin tuaj seksual dhe/ose identitetin gjinor?



Gjetjet nga përvoja me rastin e vizitës te gjinekologu i grupit të të anketuarve të cilët ndanë informacione për orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor ndryshojnë nga ato të grupit ku ky informacion nuk iu zbulua gjinekologëve. Kështu, 17.14% e grupit të parë u përballën me pyetje dhe komente të papërshtatshme në krahasim me 6.25% të grupit të dytë. 8.57% e grupit të parë përjetuan ngacmim, në krahasim me 3.13% të grupit të dytë. 11.43% e atyre që informuan gjinekologun e tyre për orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor u diskriminuan kundrejt 1.56% që u diskriminuan në grupin që nuk ndanë informacion në lidhje me të (Diagrami 12).

Diagrami 12:

Gjatë ekzaminimeve, për shkak të orientimit tuaj seksual dhe/ose identitetit gjinor a keni përjetuar...? (Po - ata ndanë informacione për OSIGj-në e tyre; Jo - ata nuk ndanë informacione për OSIGj-në e tyre)



Në të dy grupet është përafërsisht e njëjta përqindje e atyre që mendojnë se raporti me mjekun/mjekën ishte profesional, 48.57% në grupin e parë dhe 50% në të dytin. Edhe pse përqindja e atyre që zgjodhën opsionin “tjetër” ndryshon midis dy grupeve, mund të konkludohet se të dy ata kanë dokumentuar përvoja të pakëndshme nga vizita te një gjinekolog/e.

Përvojat që u ndanë nën opsionin ‘tjetër’ përfshijnë:

A. Kanë ndarë informacione rreth orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor (14.29%)

- Ajo temë shmangej, sikur të mos ekzistonte, edhe pse flisja për të dashurën time - ajo trajtohej si një i dashur, mjekja më fliste mua (mjekun) vetëm për të dashurin.
- Mjekja e parë u soll në mënyrë të papërshtatshme, megjithëse mendoj se ishte për shkak të seksizmit, jo transfobisë në atë moment, sepse unë ende nuk isha jashtë (out). Gjinekologu im aktual është i shkëlqyeshëm dhe është i njohur me identitetin tim gjinor.
- Mjekjen time e kam shoqe x 2.
- Kam marrë mbështetje nga mjekja.

B. Nuk kanë ndarë informacione rreth orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor (39%)

- Komente të tilla si “duhet të gjesh një të dashur, duhet të jesh e martuar” etj.
- Nuk e di nëse mund të jem jashtë (out) për shkak të supozimeve që mjekja tashmë po bën, dmth ajo gjithmonë supozon se kam kryer marrëdhënie heteroseksuale.
- Nëna ime e njihte mjekun dhe kështu ishte e pakëndshme për mua t’i thosha se isha pan kur kisha një problem për shkak të seksit me një vajzë.
- Nëse e mbaj mend mirë ekzaminimin e parë, pas pyetjes nëse isha seksualisht aktive, të cilës përgjigja ishte po, rrjedha e mëtejshme e bisedës dhe ekzaminimit ishte në drejtimin

dhe me supozimin se isha në një lidhje heteroseksuale, gjë që e konsideroja mjaft të papërshtatshme.

- Edhe pse nuk mund të them që jam diskriminuar, sepse nuk jam jashtë (out) dhe mjeku nuk e di që fle edhe me vajza, ka akoma pyetje të papërshtatshme sepse jam mjaft seksualisht aktive, ndërroj shpesh partnerët. Gjinekologu më këshillon fuqimisht të mos fle me shumë djem, sepse ata “nuk janë të kujdesshëm”. Por unë nuk mund t’i them atij se unë ndryshoj edhe partnere femra dhe se kam nevojë për këshilla dhe për këtë, thjesht mendoj se ai nuk do të mund të më kuptojë.
- Unë vetëm një herë isha te gjinekologu dhe nuk kam shkuar përsëri sepse më pyesnin vazhdimisht në lidhje me marrëdhëniet seksuale me djem. Nuk ishte e këndshme e gjithë situata dhe nuk e dija nëse mund të pyesja për marrëdhënie seksuale me një vajzë. Përndryshe, mjeken nuk e informova se jam lezbike.
- Ai më komentonte se duhet sa më shpejt të gjej një të dashur, sepse më duhet të lind sa më shpejt sepse kam një vezore policistike. Unë e konsideroj këtë një koment të pahijshëm.
- Ndjeva se nuk mund të flisja hapur për identitetin tim gjinor me gjinekologun.
- Heteronormativiteti nga mjekët dhe gjithmonë supozonin se isha me një partner mashkull.
- 41% e të anketuarve në këtë grup deklaruan se nuk janë ‘out’ para mjekëve të tyre dhe se mjekët supozonin se janë heteroseksualë pa pyetur.


41 % од испитаниците во оваа група навеле дека Јо се „аут“ пред нивните лекари, а дека лекарите претпоставиле дека се хетеросексуални без По прашаат.

4.2.2. Qasja në kujdesin/mbrojtjen shëndetësor parësor dhe dytësor për personat trans

Për të kuptuar më mirë përvojat që lidhen me qasjen në kujdesin shëndetësor specifik për procedurat e konfirmimit gjinor, ne kemi përgatitur një seksion të posaçëm për qëllimin e pyetësorit. Pyetjet në këtë seksion ishin të destinuara për njerëzit trans, jo binarë dhe interseksualë që kanë nevojë për kujdes shëndetësor specifik për procedurat e konfirmimit gjinor, kurse u plotësuan nga 23 të anketuar, pra 10.59% prej tyre. Nga këta të anketuar, 40.91% kërkuan shërbime shëndetësore për të filluar një proces konfirmimi gjinor (Diagrami 13).

Diagrami 13:

A keni kërkuar shërbime shëndetësore për të filluar një proces verifikimi gjinor?




Nga gjetjet mund të shihet se dy të pestat (38.46%) e të anketuarve përjetuan pyetje dhe komente të papërshtatshme, ngacmim ose diskriminim, ose një kombinim të të njëjtave (Diagrami 14). Ndër të anketuarit që zgjodhën opsionin 'tjetër', përvojat përfshijnë:

- Para tranzicionit kisha një përvojë të keqe me një internist në shëndetin publik dhe më pas fillova kalimin në një spital privat. Unë ende mendoj se është një rast diskriminimi sepse internisti bëri pyetje të papërshtatshme në lidhje me testet endokrinologjike.
- Unë vetëm bisedova me një psikiatër dhe ai më tha që nuk mund të filloja me hormonet tani për shkak të krizës KOVID-19, por shpresoj se do të mund të fillojmë së shpejti.

Diagrami 14:


Gjatë ekzaminimeve mjekësore, për shkak të orientimit tuaj seksual dhe/ose identitetit gjinor, a keni përjetuar...?



Shqetësues është fakti se një në pesë të anketuar (21.43%) nuk arritën të marrin shërbime shëndetësore edhe pse kishin nevojë për to (Diagrami 15).

Diagrami 15:

A keni marrë shërbimet shëndetësore që keni pasur nevojë?



4.3. Qasja në arsim


Gjetjet kryesore

- 49.25% u diskriminuan brenda procesit arsimor nga shokët e klasës, personeli mësimor ose administrata;
- 81.19% e tyre nuk e kanë raportuar rastin në ndonjë institucion apo organizatë kompetente;
- Te 45.68% prej tyre që nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit, arsyeja ishte frika se mund të kishte pasoja të dëmshme për ta.

Për të kuptuar më mirë përvojat e njerëzve LGBTIQ në qasjen në arsim, ne kemi përfshirë shtatë pyetje. Gjysma e të anketuarve (49.25%) u diskriminuan në procesin arsimor nga shokët e klasës, stafi mësimdhënës ose administrata (Diagrami 16). Katër nga pesë persona që përjetuan diskriminim (81.19%) nuk e raportuan rastin në asnjë institucion kompetent. Shumica e atyre që raportuan (10.89%) e bënë këtë në shërbimin profesional të institucionit arsimor, 1% raportuan në polici, 1% te Avokati i Popullit dhe 2% te një arsimtar/profesor.


Diagrami 16:

A konsideroni se keni qenë viktimë e diskriminimit në procesin arsimor?



Diagrami 17:

Nëse e keni raportuar rastin, a jeni të kënaqur me qëndrimin/sjelljen e nëpunësve në lidhje me orientimin tuaj seksual, identitetin gjinor dhe/ose shprehjen gjinore?




Shumica e të anketuarve që zgjedhën opsionin “tjetër”, pra që raportuan në polici, te një mësues/profesor ose që kanë biseduar me psikologun e tyre për rastin, shprehën pakënaqësi ekstreme (71.43%), të pakënaqur ishin 14.29% dhe 14.29% ishin të kënaqur. Më shumë se gjysma e të anketuarve që raportuan në shërbimin profesional të institucionit arsimor (58.33%) ishin jashtëzakonisht të pakënaqur ose të pakënaqur, një e treta (33.33%) ishin neutralë dhe 8.33% ishin të kënaqur me qëndrimin e zyrtarëve. Gjysma e atyre që raportuan te Avokati i Popullit ishin të pakënaqur, kurse gjysma ishin neutralë (Diagrami 17).

Për të kuptuar më mirë përvojat e pakënaqësisë dhe pakënaqësisë ekstreme, të anketuarit u pyetën se çfarë ishin vërejtjet e tyre. Pothuajse një e treta (28.57%) deklaruan se ishin diskriminuar për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore, zyrtarët kishin trajtim të papërshtatshëm për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore ose rasti ishte vonuar ose nuk kishte asnjë përgjigje nga ana e zyrtarëve për shkak të veprimit të tyre të vonuar dhe joefikas (Diagrami 18). Pjesa tjetër (14.29%) kishin shënuar diçka tjetër, kurse një prej të anketuarve më tej kishte shpjeguar se “drejtoresha e shkollës nuk i ndëshkon fëmijët që më ngacmojnë (bullying). Prindi i njërit prej atyre fëmijëve është një person shumë i rëndësishëm në qytetin tonë të vogël. Nëna ime ka raportuar disa herë, por deri më tani nuk ka pasur asnjë reagim tjetër përveç “diskutoni dhe qetësohuni”.

Diagrami 18:


Nëse i jeni përgjigjur pyetjes së mëparshme me “jashtëzakonisht të pakënaqur” ose “të pakënaqur” a keni ndonjë vërejtje lidhur me:



Pothuajse gjysma (45.68%) e atyre që nuk raportuan një rast diskriminimi për shkak të frikës se mund të kishte pasoja të dëmshme për ta: frika për sigurinë e tyre (9.88%), frika nga zbulimi i orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të anketuarit nga ana e nëpunësve (13.58%), dhe frika e dënimit dhe paragjykitimit nga rrethina e të anketuarit (22.22%). Pothuajse çdo i katërti i anketuar (23.46%) nuk ka besim se institucionet do ta zgjidhin rastin. Një përqindje e konsiderueshme (13.58%) nuk dinin ku ta raportonin rastin, dhe 6.17% e të anketuarve kishin siklet të bisedojnë me nëpunës civilë në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor (Diagrami 19).

Diagrami 19:

Nëse nuk e keni raportuar rastin, cila është arsyeja?



4.4. Qasja në punësim


Gjetjet kryesore

- 20.71% u diskriminuan në vendin e punës dhe 16.76% u diskriminuan në procesin e punësimit (gjatë intervistave, testimeve të punës, etj.) Për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore;
- 87.89% nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit në ndonjë institucion apo organizatë kompetente;
- Ndër 35.90% e të anketuarve që nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit, arsyeja për këtë ishte mosbesimi se institucionet do ta zgjidhnin rastin dhe 25.64% kishin frikë se mund të kishte pasoja të dëmshme për ta.

Pyetjet në lidhje me përvojat e diskriminimit në qasjen në punësim i referoheshin 82.49% të numrit të përgjithshëm të të anketuarve, të cilët ishin të punësuar përgjatë tre viteve të fundit (me kohë të plotë ose me kohë të caktuar) ose të cilët kishin aplikuar për një vend pune. Gjetjet tregojnë se çdo i pesti i anketuar (20.71%) ishte diskriminuar në vendin e punës, dhe një numër më i vogël (16.76%) ishin diskriminuar gjatë procesit të punësimit (gjatë intervistave, testimeve të punës, etj.), për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore (Diagrami 20).

Diagrami 20:

A mendoni se jeni diskriminuar për shkak të orientimit tuaj seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore në vendin tuaj të punës ose në procesin e punësimit?




Pothuajse nëntë nga dhjetë të anketuarit (87.80%) nuk e raportuan rastin e diskriminimit te ndonjë organ kompetent, dhe një pjesë e vogël e kishin raportuar atë në departamentin e buri-meve njerëzore ose te një person tjetër kompetent (7.32%) dhe në një organizatë joqeveritare (4.88%). Një e treta (33.33%) e atyre që raportuan diskriminim janë jashtëzakonisht të kënaqur ("Rasti u zgjidh dhe kolegja që diskriminoi, u ndal së diskriminuari"), kurse 66.67% e tjerë janë jashtëzakonisht të pakënaqur ("Vazhdoi edhe më tej, doli që unë jam fajtore. Në fund më pushuan nga puna, dhe nuk kishte asnjë arsye të qëndrueshme për këtë, mendoj se ishte për shkak të orientimit tim seksual, sepse isha i zëshme në lidhje me këtë çështje... "). I anketuari që raportoi rastin në OJQ gjithashtu shprehu pakënaqësi ekstreme me qëndrimin e punonjësve për shkak të mosnjohjes së diskriminimit ndaj një personi transgjinor nga ana e një nëpunësi.

Më shumë se një e treta (35.90%) e të anketuarve që nuk e kanë raportuar rastin e diskriminimit, arsyeja për këtë ishte mosbesimi se institucionet do ta zgjidhin rastin, dhe çdo person i katërt (25.64%) kishte frikë se mund të kishte pasoja të dëmshme ta: frika për sigurinë e tyre (7.69%), frika e zbulimit të orientimit seksual dhe/ose identitetit gjinor të të anketuarve nga nëpunësit (5.13%), dhe frika e dënimit dhe paragjyqimit nga rrethina e të anketuarit (12.82%). 5.13% e të anketuarve kishin siklet të bisedonin me një nëpunës civil në lidhje me orientimin e tyre seksual dhe/ose identitetin gjinor, dhe 17.95% prej tyre nuk dinin se ku duhej raportuar rasti (Diagrami 21).

Diagrami 21:

Nëse nuk e keni raportuar rastin, cila është arsyeja?



4.5. Dhuna dhe dhuna në familje

Gjetjet kryesore


- 51.17% kanë përjetuar një formë dhune për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore;
- 82.14% nuk e kanë raportuar rastin e dhunës në ndonjë institucion kompetent ose organizatë joqeveritare;
- Nga ata që raportuan dhunë, 73.33% ishin të pakënaqur me trajtimin e institucioneve, 53.85% për shkak të diskriminimit dhe trajtimit të papërshtatshëm nga zyrtarët për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore, dhe 46.15% për shkak të veprimit të vonuar dhe joefikas;
- 26.21% konsiderojnë se kanë qenë viktime të dhunës në familje për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore;
- 85.96% nuk e kanë raportuar rastin e dhunës në familje në ndonjë institucion kompetent ose organizatë joqeveritare;
- Te 45.83% e të anketuarve që nuk e kanë raportuar rastin e dhunës në familje, arsyeja ishte frika se mund të ketë pasoja të dëmshme për ta.

Pyetjet nga 54 deri në 69 i referohen ushtrimit të të drejtave të njerëzve LGBTIQ në lidhje me dhunën, përfshirë dhunën në familje. Gjetjet tregojnë se më shumë se gjysma e të gjithë të anketuarve (51.17%) kanë përjetuar një formë dhune për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore (Diagrami 22). Është shqetësues fakti që më shumë se katër të pestat e të anketuarve (82.14%) nuk e kanë raportuar rastin në ndonjë institucion kompetent ose organizatë joqeveritare (Diagrami 23). Nga ata 17.86% që raportuan dhunë, më shumë se dy të tretat (73.33%) ishin të pakënaqur me veprimin e institucioneve dhe më shumë se gjysma (53.85%) për shkak të diskriminimit dhe veprimit të papërshtatshëm nga zyrtarët për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore, dhe 46.15% për shkak të veprimit të vonuar dhe joefikas (Diagrami 24). Nga ata që ishin të pakënaqur

me trajtimin e institucioneve, 90% nuk e raportuan atë te ndonjë institucion apo organizatë kompetente.


Diagrami 22:

A mendoni se keni qenë viktimë e dhunës për shkak të orientimit tuaj seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore?




Diagrami 23:

A e keni raportuar rastin në ndonjë prej institucioneve/organizatave të dhëna?



Diagrami 24:


Nëse i jeni përgjigjur pyetjes së mëparshme me "jashtëzakonisht të pakënaqur" ose "të pakënaqur" a keni ndonjë vërejtje lidhur me:



Për shumicën e të anketuarve që nuk e raportuan rastin, arsyeja për këtë ishte frika se raportimi mund të kishte pasojë të dëmshme për ta (40.22%): frika për sigurinë e tyre (16.09%), frika e zbulimit të orientimit të tyre seksual dhe/ose identiteti gjinor nga ana e nëpunësit (12.64%), dhe frika e dënimit dhe paragjykitimit nga rrethina e të anketuarit (11.49%), dhe pothuajse një e treta e të anketuarve (27.59%) nuk kishin besim se institucionet do të zgjidhnin rastin (Diagrami 25).

Diagrami 25:


Nëse nuk e keni raportuar rastin, cila është arsyeja ?




Një situatë e ngjashme ndodh edhe me ata që u përgjigjën se ishin viktimë të dhunës në familje. Kështu, më shumë se një e katërta e të anketuarve (26.21%) konsiderojnë se kanë qenë viktimë të dhunës në familje për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore (Diagrami 26). Nga këto, 85.96% nuk e kanë raportuar dhunën në asnjë institucion apo organizatë përkatëse (Diagrami 27).

Diagrami 26:

A mendoni se keni qenë viktimë e dhunës në familje për shkak të orientimit tuaj seksual, identitetit gjinor ose shprehjes gjinore?

**Diagrami 27:**


A e keni raportuar rastin e dhunës në familje në ndonjë nga institucionet/organizatat e dhëna?



Nga ata 14.04% që raportuan dhunë në institucionet përkatëse, dy nga tre persona (66.67%) janë të pakënaqur me trajtimin e institucioneve dhe 60% e tyre sepse kanë përjetuar diskriminim ose trajtim të papërshtatshëm nga zyrtarët për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore (Diagrami 28). Në rastin e dhunës në familje, diskriminimi ose trajtimi i papërshtatshëm nga zyrtarët nuk u raportua te 75% e të anketuarve që kishin pasur përvoja të tilla.

Diagrami 28:


Nëse i jeni përgjigjur pyetjes së mëparshme me "jashtëzakonisht të pakënaqur" ose "të pakënaqur" a keni ndonjë vërejtje lidhur me:



Pothuajse gjysma e të anketuarve që nuk e raportuan rastin, arsyeja për këtë ishte frika se raportimi mund të kishte pasoja të dëmshme për ta (45.83%): frika për sigurinë e tyre (16.67%), frika e zbulimit të orientimit seksual dhe/ose identiteti gjinor nga ana e nëpunësit (8.33%), dhe frika e dënimit dhe paragjykitimit nga rrethina e të anketuarit (20.83%), dhe 10.42% nuk u besuan institucioneve se do ta zgjidhnin rastin (Diagrami 29). Pothuajse një e treta e atyre të anketuarve që nuk e raportuan rastin kanë shënuar opsionin "tjetër", dhe për më shumë se gjysmën e tyre arsyeja ishte që të mos e turpëronte familjen ose të çonte në pasoja të tjera psikologjike për anëtarët e tjerë të familjes. Të tjerët nuk e dinin nëse dhe ku mund të raportonin dhunën psikologjike dhe verbale.

Diagrami 29:

Nëse nuk e keni raportuar rastin, cila është arsyeja?



4.6. Veprimi i policisë

„Është absurde që policinë ta denoncoj në polici “

Gjetjet kryesore

- 71.16% kishin kontakte me oficerë policie jashtë stacionit policor, dhe më shumë se gjysma e tyre, pra 53.52% ishin të pakënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë;
- 31.31% kishin kundërshtime në lidhje me diskriminimin ose trajtimin e papërshtatshëm nga punonjësit e policisë për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore;
- 77.93% e punonjësve të policisë nuk ishin identifikuar edhe pse 12.41% e të anketuarve deklaruan se u ishte kërkuar ta bënin këtë;
- 41.18% e të anketuarve të thirrur në stacionin policor si të dyshuar ose dëshmitarë nuk ishin të kënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë ndaj tyre;
- 48% e njerëzve LGBTIQ që raportuan një rast kur ishin viktimë të një veprë penale në numrin e telefonit 192 dhe 61.9% e atyre që e bëjnë këtë në një stacion policie janë të pakënaqur me qëndrimin e dispeçerit/nëpunësit kujdestar;
- 88.95% e të anketuarve nuk i besojnë policisë se do të mbrohen nga policia ose që do t'i mbrojnë të drejtat e tyre kur ata kanë nevojë

Në pjesën mbi veprimin e policisë, pyetjet u organizuan në të njëjtën mënyrë si në hulumtimin e kryer në vitin 2015. Kështu, hulumtimi u përqëndrua në pesë grupe pyetjesh:


- 1 Veprimi i policisë me njerëzit LGBTIQ;
- 2 Trajtimi policor i viktimave LGBTIQ;
- 3 Përdorimi i forcës së pabazuar dhe të tepruar nga punonjësit e policisë kundër personave LGBTIQ;
- 4 Raportimi i rasteve të përdorimit të forcës së pabazuar dhe të tepruar nga ana e punonjësve të policisë; dhe
- 5 Besimi i njerëzve LGBTIQ se policia do t'i mbrojë kur të kenë nevojë.

4.6.1. Veprimi i policisë me njerëzit LGBTIQ

Ky grup pyetjesh ka të bëjë me qëndrimin e policisë ndaj personave LGBTIQ brenda dhe jashtë stacionit policor. Ky grup pyetjesh gjithashtu shqyrton mënyrën në të cilën zbatohen kompetenca të caktuara policore ndaj personave LGBTIQ. Sipas gjetjeve, shtatë nga dhjetë të anketuarit (71.16%) kishin kontakte me oficerë policie jashtë stacionit policor, dhe më shumë se gjysma e tyre (53.52%) ishin të pakënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë (Diagrami 30).

Diagrami 30:


A jeni të kënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë ndaj jush jashtë stacionit policor?



Nga të anketuarit që janë të pakënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë jashtë stacionit policor, një e treta (31.31%) u përgjigjën se kanë vërejtje në lidhje me diskriminimin ose sjelljen e papërshtatshme të punonjësve të policisë për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore, kurse 42.42% kishin vërejtje lidhur me veprimet e vonuara dhe joefikase (zvarritja e rastit ose mungesa e përgjigjes). Një përqindje e konsiderueshme (26.26%) zgjodhi opsionin 'tjetër' duke cituar përvojën personale të sjelljes së punonjësve të policisë jashtë stacionit policor (Diagrami 31). Kështu, 70.83% e të anketuarve që shënuan këtë opsion shprehën pakënaqësi me sjelljen e përgjithshme joprofesionale dhe abuzimin e autoritetit pavarësisht nga orientimi seksual, identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore e të anketuarve, 12.5% ishin të ekspozuar ndaj diskriminimit për shkak të gjinisë së tyre ose përkatësisë etnike dhe një person kishte përjetuar dhunë fizike nga ana e një oficeri policie.

Diagrami 31:

Nëse nuk jeni të kënaqur me trajtimin dhe veprimin e punonjësve të policisë jashtë stacionit policor, a keni ndonjë vërejtje lidhur me:



- Unë u diskriminova në bazë të orientimit tim seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore
- Veprim i vonuar dhe/ose joefikas (trajtimi i zgjatur i çështjes, mos marrja e përgjigjes, etj.)
- Qasje e papërshtatshme nga zyrtarët për shkak të orientimit tuaj seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore
- Tjetër


Perceptimi i qëndrimit joprofesional të punonjësve të policisë mbështetet edhe nga të dhënat që lidhen me zbatimin e kompetencave të veçanta të policisë. Kështu, gjetjet tregojnë se vetëm 17.24% e oficerëve të policisë e identifikuan veten me iniciativën e tyre dhe 4.83% shtesë e bënë këtë me kërkesë të të anketuarve. Të gjithë të tjerët (77.93%) nuk e identifikuan veten edhe pse 12.41% e të anketuarve deklaruan se e kërkuan atë.

Pothuajse gjysma e të anketuarve (48.65%) kur ishin në kontakt me oficerët e policisë jashtë stacionit policor iu nënshtruan ekzaminimit (inspektim vizual i fytyrës, rrobave dhe bagazheve, pa kontakt fizik). Pothuajse një e treta e të anketuarve (27.52%) iu nënshtruan një kontrolli (ekzaminim fizik të fytyrës, rrobave dhe bagazheve, me kontakt fizik dhe inspektim të drejtpërdrejtë të rrobave dhe bagazheve) jashtë stacionit policor. Në vetëm një rast oficerët e policisë treguan një urdhër gjykate për kontroll, ndërsa në të gjithë të anketuarit e tjerë e bënë këtë pa një urdhër gjykate, i cili është në kundërshtim me aktet ligjore.

Nga ata të anketuar që kishin kontakte me oficerët e policisë në një stacion policie (për ndonjë arsye tjetër përveçse si viktimë e një krimi) 13.27% e të anketuarve u përgjigjën se ishin thirrur si dëshmitarë, 6.16% si të dyshuar. Nga ata që u thirrën në një stacion policor si të dyshuar ose dëshmitarë, 41.18% ishin të pakënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë ndaj tyre (Diagrami 32). Për më shumë se një të katërtën e tyre (27.78%), arsyeja e pakënaqësisë ishte qëndrimi i papërshtatshëm i policit për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore, për një të tretën (33.33%) arsyeja ishte veprimi i vonuar dhe joefikas i punonjësit të policisë (Diagrami 33). Ata 38.89% që zgjedhën opsionin “tjetër” deklaruan se arsyeja e pakënaqësisë ishte se punonjësit e policisë përdorën forcë të tepruar, përdorën kërcënime dhe kanosje, diskriminuan në baza etnike ose kishin një marrëdhënie joprofesionale që nuk lidhej me orientimin seksual, identitetin gjinor dhe/ose shprehjen gjinore.


Diagrami 32:

A jeni të kënaqur me qëndrimin e punonjësve të policisë ndaj jush në stacionin policor?



Diagrami 33:

Nëse nuk jeni të kënaqur me trajtimin dhe veprimin e punonjësve të policisë në stacionin policor, a keni ndonjë vërejtje në lidhje me:




4.6.2. Trajtimi policor i viktimave LGBTIQ

Ky grup pyetjesh kërkon të kuptojë hapjen e njerëzve LGBTIQ për të komunikuar me policinë në rastet kur ata janë viktimë të krimit, si dhe për të kuptuar se si ata u trajtuan nga punonjësit e policisë kur e bënë këtë.

Një e pesta e të anketuarve (20.28%) raportuan një rast në polici kur ishin viktimë të një krimi, 11.79% në numrin e telefonit 192 dhe 8.49% në stacionin policor. Nga ata që raportuan rastin në numrin e telefonit 192, pothuajse gjysma (48%) ishin të pakënaqur me qëndrimin e dispeçerit të policisë. Pakënaqësia është në një nivel më të lartë në mesin e atyre të anketuarve që raportuan krimin në një stacion policie ku 61.9% e të anketuarve ishin të pakënaqur me qëndrimin e oficerit të policisë (Diagrami 34).


Diagrami 34:

Sa jeni të kënaqur nga qëndrimi/sjellja i dispeçerit/oficerit të policisë kur keni raportuar një vepër penale.



Diagrami 35:

Arsyet e pakënaqësisë me qëndrimin/sjelljen e dispeçerit/oficerit të policisë gjatë raportimit të një vepre penale.




Të dhënat tregojnë përqindje pothuajse identike të të anketuarve që u përballën me sjellje të vonuar dhe joprofesionale nga dispeçerët/oficerët e policisë, madje dhe kur raportuan një vepër penale në numrin e telefonit 192 (57.89%) ose në stacionin policor (60%). Diskriminimi i perceptuar për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe/ose shprehjes gjinore të të anketuarve është më i përfaqësuar me rastin e raportimit të një vepre penale në numrin e telefonit 192 (10.53%), kundrejt kur raportohet në një stacion policie (6.67%). Të gjithë të anketuarit që shënuan opsionin "tjetër" deklaruan se arsyeja për këtë ishte qëndrimi i përgjithshëm joprofessional i dispeçerëve/oficerëve të policisë pavarësisht nga orientimi seksual, identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore e të anketuarve (Diagrami 35).

4.6.3. Përdorimi i forcës së pabazuar dhe të tepruar nga punonjësit e policisë kundër personave LGBTIQ

Ky grup pyetjesh fokusohet në përvojat e njerëzve LGBTIQ kur ata iu nënshtruan forcës së tepërt dhe të pabazuar të policisë dhe arsytet për këtë. Gjetjet tregojnë se pothuajse një e dhjeta (8.84%) e të anketuarve që kishin kontakte me oficerët e policisë jashtë stacionit të policisë besojnë se ata iu nënshtruan një force të pabazuar dhe të tepruar. Numri është më i ulët (6.12%) i atyre që besojnë se forca e pabazuar dhe e tepruar u aplikua ndaj tyre në një stacion policie (Diagrami 36). Pothuajse gjysma (46.15%) e të anketuarve që deklaruan se i ishin nënshtruar forcës së tepërt dhe të pabazuar të policisë jashtë stacionit policor, besojnë se orientimi i tyre seksual, identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore është arsyeja për këtë. Të gjithë të tjerët që deklaruan se i ishin nënshtruar forcës së tepërt dhe të pabazuar të policisë brenda dhe jashtë stacionit policor, ngurronin të përgjigjeshin nëse orientimi seksual, identiteti gjinor dhe/ose shprehja gjinore ishte shkaku i dhunës.

Diagrami 36:

Vallë gjatë kontakteve me oficerët e policisë, ata kanë përdorur forcë të paarsyeshme ose të tepruar ndaj jush (jashtë stacionit policor)?




4.6.4. Raportimi i rasteve të përdorimit të forcës së pabazuar dhe të tepruar nga punonjësit e policisë

Asnjë nga të anketuarit që deklaroi se i ishte nënshtruar forcës së tepërt dhe të pabazuar të policisë në një stacion policie, nuk e raportoi atë tek ndonjë autoritet kompetent. Arsyet kryesore për këtë ishin: mosbesimi se policia do të zgjidhë rastin (50%), frika për sigurinë e tyre (16.67%) dhe mungesa e informacionit se ku të raportohet rasti në fjalë (16.67%). „Është absurde të denoncoj policinë në polici “ është deklarata e njërit prej të anketuarve që kishte shënuar opsionin ‘tjetër’ (Diagrami 37).

Diagrami 37:


Arsyet për mos raportimin e një rasti të forcës së pabazuar ose të tepruar të kryer në një stacion policie?



Nga ata që raportuan se i ishin nënshtruar forcës policore të tepruar dhe të pabazuar jashtë stacionit policor, 17.64% e raportuan rastin në Sektorin për Kontrollin e Brendshëm dhe Standardet Profesionale të Ministrisë së Brendshme (5.88%) dhe/ose te një organizatë joqeveritare (11.76%). Shumica e të anketuarve (77.78%) nuk e kanë raportuar rastin në asnjë institucion apo organizatë, dhe arsyet e dhëna për këtë përfshijnë: frikën për sigurinë e tyre (20%), frikën e zbulimit të orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor nga nëpunësit e policisë (13.33%), mosbesimi se policia do të zgjidhë rastin (53.33%) dhe mungesa e informacionit se ku duhej të raportohej rasti (6.67%) (Diagrami 38).

Diagrami 38:

Arsyet për mos raportimin e një rasti të forcës së pabazuar ose të tepruar të kryer jashtë një stacioni policor?




4.6.7. Besimi i njerëzve LGBTIQ se policia do t'i mbrojtë kur të kenë nevojë

Pyetja e fundit në këtë pjesë të pyetësorit kishte të bënte me të gjithë të anketuarit pavarësisht nëse kishin apo jo kontakt me policinë, dhe qëllimi ishte të shqyrtohej besimi i tyre ndaj policisë se do t'i mbronje ata dhe të drejtat e tyre kur të kishin nevojë. Nëntë nga dhjetë të anketuarit, pra 88.95% janë përgjigjur se nuk i besojnë policisë për t'i mbrojtur ata ose të drejtat e tyre kur kanë nevojë (Diagrami 39).

Diagrami 39:

A keni besim se policia do t'ju mbrojë ju ose të drejtat tuaja kur keni nevojë për to?



4.7. Qasja në shërbimet e tjera

Gjetjet kryesore


- 47.47% e të anketuarve u përgjigjën se ka një organizatë ose institucion në vendbanimin e tyre që mund t'u përgjigjet pyetjeve që lidhen me problemet me të cilat ballafaqohen personat LGBTQ. 77.67% e tyre jetojnë në kryeqytet;
- 77.27% e të anketuarve që kanë kërkuar ndihmë juridike falas te një organizatë janë të kënaqur me ndihmën që kanë marrë;
- 75.56% e të anketuarve deklaruan se u besojnë OJQ-ve që t'i ndihmojnë në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në këtë grup pyetjesh, pothuajse gjysma e të anketuarve (47.47%) u përgjigjën se ekziston një organizatë ose institucion në vendbanimin e tyre që mund t'u përgjigjet pyetjeve që lidhen me problemet me të cilat ballafaqohen personat LGBTQ. Shumica e tyre (77.67%) janë të anketuar nga Shkup. Më shumë se një e treta (37.33%) mendojnë se ka një organizatë ose institucion në vendbanimin e tyre që ofron këshillim dhe mbështetje psiko-sociale dhe 28.57% kanë njohuri për një organizatë që ofron ndihmë juridike falas për personat LGBTQ. Në mënyrë të ngjashme, ky lloj organizatash është më së shumti i njohur për të anketuarit që jetojnë në Shkup, pra 81.81% dinë për organizatat që ofrojnë ndihmë psiko-sociale dhe 81.96% që ofrojnë ndihmë juridike.


Edhe pse vetëm një pjesë e vogël e të anketuarve (8.88%) iu janë drejtuar një organizate për ndihmë juridike falas (Diagrami 40), shumica e tyre (77.27%) ishin të kënaqur me ndihmën e marrë (Diagrami 41). Për më tepër, një përqindje shumë e lartë e të anketuarve (75.56%) deklaruan se kanë besim tek OJQ-të për t'i ndihmuar ata të ushtrojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre (Diagrami 42).

Diagrami 40:


A keni kërkuar
ndihmë juridike falas
në një organizatë?

**Diagrami 41:**

Nëse keni kërkuar
ndihmë, a jeni të
kënaqur nga ndihma
e marrë?

**Diagrami 42:**

A i besoni OJQ-ve
që t'ju ndihmojnë të
ushtroni dhe mbroni
të drejtat tuaja?



4.8. Informacion nga ana e institucioneve


Gjetjet kryesore

- 98% e të gjithë të anketuarve besojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm për të njohur dhe raportuar diskriminimin, 94,42% për të identifikuar dhe raportuar dhunën bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor ose shprehjen gjinore;
- 93.97% e të anketuarve mendojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm që do t'i ndihmonte në procesin e vetë-avokimit, si dhe praktikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në fushën e mbrojtjes ligjore, sigurisë personale dhe mbrojtjes nga dhuna

Shumica e të anketuarve mendojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm se si të identifikojnë diskriminimin dhe dhunën bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor dhe/ose shprehjen gjinore dhe ku të drejtohen për të siguruar mbrojtje ligjore. Kështu, 98% e të gjithë të anketuarve besojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm për të identifikuar dhe raportuar diskriminimin bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor ose shprehjen gjinore (Diagrami 43), 94.42% e të anketuarve besojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm për të identifikuar dhe raportuar dhunën bazuar në orientimin seksual, identitetin gjinor ose shprehjen gjinore (Diagrami 44) dhe 93.97% e të anketuarve mendojnë se institucionet nuk japin informacion të mjaftueshëm që do t'i ndihmonte në procesin e vetë-avokimit, si dhe praktikimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre në fushën e mbrojtjes ligjore, sigurisë personale dhe mbrojtjes nga dhuna (Diagrami 45).


Diagrami 43:

